



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Administrim
Biznesi”**

ofruar nga

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Dr. Ermira Qosja

Prof. Asoc. Dr. Elena Kokthi

Qershor/2025

**Tabela Përmbledhëse me të dhënat Për Programin e studimit Master Profesional në
“Administrim Biznesi” ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan.S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Administrim Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 1287/1, datë 15.03.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MAS - Nr. 1287/1, dt 15.03.2019
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr: 59, datë 15.03.2022.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023: 9 PAE/0 PAK 2023-2024: 9 PAE/0 PAK 2024-2025: 9 PAE/0 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023: 22 studentë 2023-2024: 24 studentë 2024-2025: 18 studentë
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Fan.S.Noli" Korçë më tej UNIKO, është një institucion publik i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". "UNIKOK" është liçencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 230, datë 29.05.1992 dhe është riorganizuar me VKM Nr 213, datë 24.05.1994".

IAL "UNIKO" është organizuar në 4 Fakultete: **1. Fakulteti i Ekonomisë 2.Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, 3. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane dhe 4.Fakulteti i Bujqësisë (FB).** Programi i studimit të ciklit të dytë në "Administrim Biznesi" ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë.

Fakulteti i Ekonomisë është i përbërë nga tre departamente:

1. Departamenti i Menaxhimit
2. Departamenti i Financë- Kontabilitetit
3. Departamenti i Marketing -Turizmit


Departamenti i Menaxhimit ofron programet e studimit :

- | | |
|-----------------------------|------------------------------|
| 1. <u>në ciklin e parë:</u> | Bsc në "Menaxhim" |
| 2. <u>në ciklin e parë</u> | Bsc në "Informatikë Biznesi" |
| 3. <u>në ciklin e parë</u> | DP në "Asistent Menaxher" |
| 4. <u>në ciklin e dytë:</u> | MP në "Administrim Biznesi"; |

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit MP në "Administrim Biznesi" Programi i studimit është licencuar me VKM nr. 1287/1 datë 15/03/2019 dhe riorganizuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 575 datë 01/10/2018. Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi të ofruar nga departamenti përkatës pranë IAL është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UK dhe Rregullorja e programit të studimit.

Programi i Masterit Profesional në "Administrim Biznesi" në UNIKO synon të formojë specialistë të aftë për të përballuar sfidat e tregut të punës në sektorin privat dhe publik. Programi ofron një bazë teorike në fushat kyçe të administrimit të biznesit, si menaxhimi strategjik, qeverisja korporative dhe vendimmarrja menaxheriale. Megjithatë, për të rritur përputhshmërinë me kërkesat dinamike të tregut, rekomandohet integrimi i moduleve mbi sipërmarrjen, inovacionin dhe transformimin digjital. Gjithashtu, krijimi i marrëveshjeve me biznese për praktika profesionale dhe ofrimi i lëndëve në gjuhën angleze do të përmirësonin punësueshmërinë dhe

ndërkombëtarizimin e studentëve. Këto përmirësime do të kontribuonin në një program më tërheqës dhe të përshtatshëm për sfidat e tregut aktual të punës. Në këtë kontekst, integrimi i praktikës profesionale në kategorinë D të programit është një hap i rëndësishëm drejt përgatitjes së studentëve për sfidat reale të mjedisit të biznesit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Ermira Qosja dhe Prof. Asoc.Dr. Elena Kokthi. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik e ASCAL, Znj. Alma Arapi.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi”, i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit të Fakultetit të Ekonomik pranë Universitetit të Korçës, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në UNIKO, u realizua në datën 5 dhe 6 Mars 2025, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në UNIKO, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Dekanen e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, zvrktoren për Kerkimin Shkencor; si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit MPAB, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Universiteti “Fan.S.Noli”,Korçë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 19.05.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 36 / 57 Prot, datë 19.05.2025. Universiteti “Fan.S.Noli”,Korçë njofton në ASCAL më datë 27.05.2025, me anë të shkresës me Nr.390/3 Prot, datë 27.05.2025 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Administrim Biznesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Departamenti i Menaxhimit i Fakultetit Ekonomik në vizionin e tij për programin MPAB ka synuar të krijojë një model bazuar në përvojën e institucioneve më të mira të arsimit të lartë në Shqipëri, duke marrë në konsideratë nevojat e Qarkut të Korçës përmes bashkëpunimeve me institucionet e tij, si dhe përvojën e bashkëpunëtorëve ndërkombëtarë. Ruajtja dhe konsolidimi i vlerave kombëtare shprehet dhe në nenin 2 të Statutit të UNIKO, por konfirmohet dhe në takimin me Dekanen dhe Përgjegjësen e Departamentit, të cilat mbajnë qëndrimin që ky program synon investimin e duhur në kapitalin human, që do të kontribuojnë në rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm të sipërmarrjeve, lidhjen universitet-industri dhe është një kontributor i rëndësishëm për përgatitjen e specialistëve për tregun e punës në Qark e më gjerë. <i>Dokumenti 2: Raporti i GVB</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.1. Statuti i UNIKO</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi MPAB është hartuar në përputhje me Misionin e UNIKO, për të krijuar, zhvilluar, percjellë dhe mbrojtur dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, për të formuar specialistë të lartë në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, gjithashtu reflekton Strategjinë e UNIKO 2022-2027, si dhe përfaqëson e FE të reflektuar në Planin e Zhvillimit të FE për periudhën 2021- 2025. Harmonizimi i teorisë me nevojat e tregut shqiptar dhe atij rajonal është bërë i mundur përmes njohurisë dhe aftësisë së stafit akademik dhe kompetencës së tyre për t’u përshtatur me rastet studimore, projektet apo mikrotezat e kompanive shqiptare dhe të ekonomisë shqiptare dhe rajonale. <i>Dokumenti 2: Raporti i GVB</i>

	<i>Dokumenti Shtojca 1.1. Statuti i UE</i> <i>Dokumenti Aneksi I.15: Planin e Zhvillimit të FE për periudhën 2021-2025</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Programet lëndore</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Në takimin me Dekanen e Fakultetit dhe drejtuesen e departamentit përforcuam mendimin se programi MPAB është në përputhje të plotë me vizionin e UNIKO dhe të FE dhe suksesi i tij në vite ka qenë i qenësishëm, reflektuar kjo dhe në numrin pothuaj stabël të studentëve në disa vite. Të bindur për avantazhet që programi dhe departamenti ofron përkundrejt programeve master të fakultetit, drejtuesit e FE dëshmuar që programi MPAB shërben për formimin e profesionistëve për tregun e punës lokal, kombëtar dhe global, dhe kjo e mundur nga kurrikula dhe metodologjitë e përdorura në mësimdhënie. Struktura e programit të studimit MPAB reflekton VKM 41/2018 (për këtë arsye është bërë riorganizimi i tij në vitin 2019 duke kaluar nga MPAB me 90 kredite në MPAB me 60 ECTS) dhe standardet e parashikuara në Statutin e UNIKO <i>Dokumenti Aneksi 1.25: Plani i Zhvillimit të FE</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.26: Mendimi Dekanit</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.27: Vendimi i MASH për riorganizimin</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.1. Statuti i UE</i> <i>Dokumenti Aneksi I.32: Programi studimit</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Programet lëndore</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Gjatë shqyrtimit të RVB, Strategjisë së FE, Planit Mësimor, Silabuseve të lëndëve, evidentohet që programi MPAB është hartuar duke marrë në konsideratë formimin e specialistëve me aftësi menaxheriale, për të punuar në SME dhe ndërmarrjet e mëdha shqiptare, por dhe për të qenë të përgatitur për një treg më global. Gjatë takimit me stafin akademik të Departamentit të Menaxhimit, u diskutua sesi ata përcjellin njohuritë që vijnë përmes teksteve të huaja dhe realitetit shqiptar përmes rasteve studimore, projekteve, të ftuarve në auditor dhe vizitave në biznese. <i>Dokumenti 2: Raporti i GVB</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.25: Plani i Zhvillimit të FE</i> <i>Dokumenti Aneksi I.32: Programi studimit</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Programet lëndore</i>

Konkluzione	GVJ bazuar në sa më lart vlerëson se Departamenti i Menaxhimit i FE ofron programin e studimit MPAB në përputhje me misionin dhe qëllimin e UNIKO, duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Departamenti i Menaxhimit, pjesë e FE të UNIKO në vite ka arritur të krijojë një përvojë pozitive brenda universitetit dhe më gjerë. Në përbërje të departamentit ka staf akademik që mban titullin Prof.Asoc dhe Dr. në fushën e menaxhimit, ndërkohë në vite kanë arritur të ndërtojnë dhe mbajnë një bashkëpunim shumë pozitiv dhe me profesoratin e Fakultetit Ekonomik të UT, gjë që ka kontribuar në përmirësimin e kurrikulave dhe në avancimin akademik të stafit. Programi MPAB tashmë ka krijuar një ekperiencë mbi 10 vjeçare në Arsimin e Lartë në Shqipëri, ekperiencë e cila është pasuruar dhe përmes projekteve europiane dhe ndërkombëtare në të cilin departamenti dhe stafi i tij është përfshirë. Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, i cili ka 3 (tre) departamente: 1. Departamenti Menaxhimit; 2. Departamenti Financë Kontabilitet; 3. Departamenti Marketing dhe Turizmit Burimet njerëzore: Stafi akademik bazuar në CV-të rezulton me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të menaxhimit. Nga të dhënat që jepen në DVV, Shtojcat nga I.29- I.31, rezulton se Fakulteti i Ekonomisë për vitin akademik 2024-2025 ka gjithsej 31 pedagogë efektivë, nga të cilët 14 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 15 kanë gradën Dr, dhe 2 Asistent Lektorë në proces doktorature;

	Ndërsa në Departamentin e Menaxhimit për vitin akademik 2024-2025, janë 9 lektorë, si personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 4 janë me titullin “Profesor i Asociuar”, 4 “Doktorë” dhe një doktorant. Në programin e studimit MPAB për vitin 2024-2025 janë angazhuar 9 pedagogë, nga të cilët: 1 me titullin prof (nga Departamenti i Shkencave Sociale - UNIKO); 4 me titullin “Prof. Asoc”, dhe 4 me graden “Doktor”. Nga analiza e dokumentacionit (shtojca I.31) GJV evidenton që stafi akademik i departamentit ka nevojë për një përjasje më proaktive ndaj kërkimit, projekteve dhe karrierës së tyre akademike. Natyrisht, nëse do i referohemi kriterëve ligjorë të masterit, departamenti i plotëson, por zhvillimet e fundit në teknologji kërkojnë një dinamikë tjetër. <i>Dokumenti 2: Raporti i GVB</i> <i>Dokumenti Shtojca I.29: Personeli akademik dhe ndihmës i FE</i> <i>Dokumenti Shtojca I.30: Personeli akademik programit MPAB</i> <i>Dokumenti Shtojca I.31: Të dhëna mbi personelin akademik</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi MPAB është në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UNIKO, që përcaktojnë Departamentin e Menaxhimit si njësi bazë të njësisë kryesore të Fakultetit Ekonomik. Struktura e programit është në përputhje të plotë me Statutin e UNIKO dhe organizimi i studimeve bëhet bazuar në disa nene të Rregullores së Fakultetit Ekonomik. <i>Dokumenti Shtojca I.1: Statuti UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi I.28: Rregullore e FE</i> <i>Dokumenti Shtojca I.32 Programi studimit MPAB</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese	Bazuar në “Strukturën e programeve të FE për të dyja ciklet e studimit”, programi MPAB përputhet plotësisht me fushën akademike dhe të kërkimit të Departamentit të Menaxhimit. Qëllimi i formimit në këtë program studimi ka të bëjë jo vetëm me zhvillimin e ekonomisë lokale dhe kombëtare, por vlerësojmë që synon të përgatisë studentët për një botë globale. Pedagogët gjatë takimit u shprehën se si përmes programit, gërshtimit të lokale dhe globale, përpiqen të krijojnë një strukturë programi që përgatit studentët me aftësi menaxheriale që koha kërkon. <i>Dokumenti Aneksi I.28: Rregullore e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi I.32: Programi studimit</i>

duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<i>Dokumenti Aneksi II.15: Programet lëndore</i>			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	NA			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Qendra e Karrierës dhe Alumnit është një njësi që po merr jetë në UNIKO dhe në bashkërendim me departamentin/fakultetin po përpiqen që krahas marrëveshjeve me institucione/organizata dhe orientimit të studentëve në intershipe dhe punësim, të luajnë brenda universitetit një rol më proaktiv dhe përmes trajnimeve profesionale. Gjatë vizitës në institucion, stafi i Qendrës së Karrierës na informoi për një sërë aktivitete të bëra me këtë qëllim. Gjithashtu, Qendra e Inovacionit e krijuar përmes një projekti evropian po luan një rol proaktiv në zhvillimin e aftësive dhe mbështjetjen e sipërmarrjes së studentëve. <i>Dokumenti Aneksi 1.33 – 1.35: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.2: Rregullore e UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi II.21: QKA – Analiza e veprimtarisë</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që programi i studimit MPAB është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen	Programi MPAB për vetë përmbajtjen e lëndëve që ka menaxhohet plotësisht nga Departamenti i Menaxhimit. Bazuar në Ligjin e

dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatese dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Arsimit të Lartë Nr 80/2015, Statutin e Rregulloren e UNIKO, në Rregulloren e Fakultetit dhe të Departamentit, ky i fundit ushtron kompetencat e tij në lidhje me hapjen, riorganizimin, përshtatjen dhe mbylljen e programeve të studimit. Gjithashtu, Departamenti mban përgjegjësi për menaxhimin e përmbajtjes së lëndëve, mënyrën e zhvillimit të tyre, përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në kohë. Në funksion të mbarëvajtjes së punës në administrimin e MPAB, departamenti analizon çdo vit akademik nevojën e programit për përmirësim të vazhdueshëm. Në veprimtarinë e Departamentit vend të veçantë zënë dhe mbledhjet dhe vendimet që merren, të cilat pasqyrohen në vendimet e Departamentit të Menaxhimit. <i>Gjatë takimit me stafin akademik nënvizua nevojën e një studimi tregu vetëm për këtë program studimi, vlerësimin e tij dhe përmes tryezave me tregun e punës, alumnit dhe studentët aktualë.</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.1: Statuti UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullore e FE</i> <i>Dokumenti Shtojca I.32 Programi studimit MPAB</i> <i>Dokumenti II.9: Rregullore Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullore Programit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.11: Ndryshime në Planin Mësimor</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Eksperiencia dhe tradita që Fakulteti Ekonomik ka brenda UNIKO në shumë vite, krijon oportunitete për bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit. FE dhe Departamenti Menaxhimit kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi dhe me organizata publike dhe kompani private si shihet në Anekset 1.33, 1.34 dhe I.35. Roli i departamentit është i rëndësishëm, megjithatë <i>Departamenti i Menaxhimit dhe FE kanë mundësi për më shumë bashkëpunime me industrinë dhe më shumë efikasitet në bashkëpunim me ta. GVJ rekomandon ndërtimin e skemave formale të bashkëpunimit me industrinë dhe gjetjen e rrugëve që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikant/interhipet e tyre, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe startapeve të reja, patentat etj.</i> Gjithashtu, Departamenti dhe Fakulteti në bashkëpunim me QKA duhet të rrisin bashkëpunimin midis tyre dhe të zhvillojnë strategjitë e duhura.

	Gjithashtu, gjatë takimit me pedagogët e departamentit dhe drejtuesit e tij dhe të fakultetit u theksua nevoja për një përqasje tjetër ndaj bashkëpunimeve me universitetet e huaja dhe punës me projekte. <i>Dokumenti Aneksi 1.33 – 1.35: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Programi Master Profesional në Administrim Biznes, nuk përmban praktikën mësimore, që në kushtet e një programi që e konsiderojmë shumë të rëndësishëm për formimin e kompetencave profesionale në menaxhim për një gamë të gjerë profesionistësh, përbën një “must” për t’u ndryshuar e zhvilluar në skema që biznesi lokal do e kërkonte. Gjatë takimit me pedagogët e departamentit të menaxhimit, ata u shprehën që po mendojnë dhe punojnë në këtë drejtim, por <i>nuk gjetëm një plan të qartë si do e organizonin dhe operacionalizonin.</i> <i>Dokumenti Shtojca I.32 Programi studimit MPAB</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në nivel institucional, çdo vit akademik përpilon raportet vjetore të departamentit, fakultetit dhe universitetit si dhe raportet nga pyetesorët me studentët. Ndërkohë në nivel program studimi, një pjesë e mbledhjeve të departamentit trajtojnë çështje dhe problematika që lidhen me MPAB. Megjithatë, GVI nuk evidenton një raport konkret ku të analizohen përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. <i>Dokumenti 1.12: Analiza Vjetore Institucionale 2021-2022</i> <i>Dokumenti Aneksi II. 11 : Ndryshime në Planin Mësimor</i> <i>Dokumenti Aneksi II.20: Raporti vjetor Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Dokumenti Aneksi II.21. Raporti vjetor i QKA</i>

Konkluzione	<i>GVJ vlerëson përpjekjen e institucionit në lidhje me bashkëpunimet me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobiliteti, por mendon që duhet një përjasje më proaktive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi MP në Administrim Biznes; është hapur me VKM Nr. 1287/1, dt. 15.03.2019 (riorganizuar). Qëllimi i programit MPAB është të formojë dhe aftësojë individë për tregun e punës dhe t'u krijojë atyre avantazh konkurrues në të. Mbështetur në të gjithë dokumentacionin e paraqitur, MPAB karakterizohet: - 1 vit akademik/2 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - ngarkesa mësimore 600 orë në auditor; 900 orë jashtë tij; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. Programi strukturohet në: - Kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 1 lëndë, 5 ECTS. 8 % e krediteve (standardi 5%-10%); - Kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: 5 lëndë, 25 ECTS, 41.6 % e krediteve (standardi 30%- 40%) - Kategoria C - lëndë ndërsiplinore 3 lëndë, 15 ECTS – 25 % e krediteve (standardi 20%- 30%)

Prolet

[Signature]

	- Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Metodologji kërkimi 6 ECTS, 10% e krediteve (standardi 10%) ; - Kategoria E – detyrime përmbyllëse: Diploma 9 ECTS, 15% e ECTS (standardi 10%- 20%). Gjatë shqyrtimit të programit MPAB, qartë evidentohet mungesa e Praktikës Profesionale – kategoria D. Në takimin me stafin dhe drejtuesit u evidentua ky fakt, por si u përmend edhe më sipër duke jo e qartë rruga e zgjidhjes. Gjitashtu, qartë më lart duket që lëndët karakterizuese tejkalojnë në kredite kufirin e sipërm të standardit. <i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ evidenton se syllabuset e lëndëve janë formuluar pjesërisht në përputhje me udhëzimet dhe dispozitat ligjore, gjithashtu nevojitet të përmirësohet përmbajtja e temave, GVJ rekomandon të detajohet literatura e çdo teme dhe të jetë literaturë e 5 viteve të fundit, të rishikohet forma e vlerësimit duke ju përshtatur qëllimit të MP duke integruar më shumë elementë praktikë në kontrollin e vazhduar të njohurive.</i> <i>Dokumenti Aneksi II.2.: Plani mësimor i programit</i> <i>Dokumenti Shtojca I.32 Programi studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Programet lëndore</i>
Kriteri 2.Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një	MPAB synon të formojë dhe aftësojë studentët në një spektër relativisht të gjerë të kompetencave menaxheriale dhe t'u krijojë avantazh konkurrenës në tregun e punës, lokal dhe kombëtar. <i>Gjatë vizitës në institucion drejtuesit e tij shprehen me një lloj rezistence ndaj ndryshimeve në përmbajtjen e programit. Ndërkohë u dakordësuam që nevojitet të bëjnë një studim tregu vetëm për këtë program studimi si dhe të kenë një përqasje më ndërvetpruese me biznesin lokal, për të patur një sens më konkret në lidhje me përmbajtjen e këtij programi, më specifikisht në lidhje me lëndët dhe përmbajtjen e tyre</i> <i>Spektri i formimit është relativisht i gjerë (syllabuset) dhe kjo shërben në kushtet e një tregu të vogël si Shqipëria, por në transformimet e reja dhe shumë dinamike që po pëson menaxhimi dhe tregu i punës sot, kërkohet më shumë specializim në drejtime të veçanta. Programi nën këndvështrimin edhe të ekspertëve të jashtëm mund të kishte prezencë të më shumë elementëve sipërmarrje, inovacion, digjitalizim dhe marketing.</i>



fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<i>Dokumenti Shtojca I.32 Programi studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Programet lëndore</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programit MPAB siç e kemi theksuar dhe më lart, në kategorinë D të lëndëve të formimit plotësues, nuk përmban praktikën mësimore. Departamenti është duke bërë analizat për mënyrën se si duhet ta vendosë në program në mënyrë më efikase. Në lidhje me detyrimin përmbyllës, punimin e diplomës e cila në programin mësimor mban një peshë prej 9 ECTS, departamenti ka përpiluar dokumentacionin: Udhëzuesin e punimit të diplomës. Gjatë vizitës në institucion, stafi u shpreh që në temën e punimit të diplomës përpiqen ta lidhin me interesin profesional të studentit, përse i përket <i>çështjes së plagjiaturës dukej që mbetej në ndërgjegjën e pedagogut udhëheqës dhe të përgjegjshmërisë profesionale të pedagogut oponent. Gjithashtu nuk u evidentua një praktikë institucionale në realizimin e bashkëpunimit pedagog-student gjatë procesit të shkrimit të tezës, përveç emailit. Hartimi i një syllabusi për drejtimin e studentit gjatë këtij procesi do të ndihmonte si studentin edhe pedagogun për një mbarëvajtje më të mirë të procesit.</i> <i>Dokumenti Shtojca I.32 Programi studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.6: Udhëzuesi i diplomës</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësuar i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e	NA



mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6.Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	NA
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit MPAB ka patur gjithnjë si udhërrëfyes programet e e Fakultetit Ekonomik të UT, jo vetëm për përvojën por dhe për faktin që në vite profesorati i FEUT ka kontribuar në mësimdhënie, në përmirësimin e programit dhe në hartimin e silabuseve, megjithatë në takimin me stafin e angazhuar në këtë program studimi u diskutua mbi përshtatjet që duhet që ky program të reflektojë për të pasqyruar dinamikat locale të zonës së Korçës. <i>Dokumenti Shtojca I.32 Programi studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Programet lëndore</i>
Kriteri 8.Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra	Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve¹, programi i studimit MPAB i përket nivelit 7.

¹ https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/LIGJ-10247-2010_korniza_shqiptare_e_kualifikimeve.pdf



publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në Aneksin 1.36 – Pasqyrimi i Kodifikimit të programit MPAB Si rregull përdoren akronimet e programit të studimit MPAB Nuk gjetëm një dokument të kodifikimit të lëndëve. Kodifikimi i këtij program është 71MP 0413 S <i>Dokumenti Aneksi 1.36: Kodifikimi i programit të studimit</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se në lidhje me standardin “Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore” duhet të të synohet në afatshkurtër përshtatja e programit me dinamikën e tregut dhe sistemit plotë i silabuseve në përputhje me kërkesat e ligjit. Gjithashtu, do të duhet të përdoren programet e antiplagjaturës për punimet e diplomës dhe detyrat, si dhe të bëhen përpjekje për përfshirjen e praktikës në program</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për	UNIKO është akredituar me Vendimin Nr 02 të vitit 2023 të Bordit të Akreditimit. Fakulteti Ekonomik i Universiteti “Fan S. Noli” të Korçës ka në përbërje të tij, 3 njësi bazë si më poshtë: 1. Departamentin e Menaxhimit; 2. Departamentin e Marketingut dhe Turizmit; 3. Departamentin e Financë – Kontabilitetit Fakulteti Ekonomisë dhe Departamenti i Menaxhimit në kohë nga pikëpamja strukturore ka reflektuar ndryshimet ligjore në Arsimin e Lartë. Fakulteti

ECOE

[Signature]

organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Ekonomik ofron programe studimi në dy cikle: Bachelor dhe Master. Departamenti i Menaxhimit mbulon 4 programe studimi: 1 Diplomë Profesionale në “Asistent menaxher” (akredituar); 1 Bachelor në “Menaxhim Biznesi” (akredituar); 1 Bachelor në “Informatikë Biznesi” (proces akreditimi) dhe Masterin Profesional – akreditimi i të cilit synohet përmes procesit të vlerësimit aktual.

Në Aneksin I.29 paraqitet numri i personelit për çdo njësi bazë të FE-UNIKO, evidentohet që të 3 njësitë bazë së bashku kanë në përbërje 31 pedagoge, çdo njësi ka 9 deri 13 PAE duke plotësuar kriterin ligjor në lidhje me numrin dhe tituj/ grada.

Në Aneksin I.29 evidentohet që Departamenti Menaxhimit ka 9 PAE (duke plotësuar kriteret ligjore) nga të cilët:


- Kategoria profesor - 4 (Prof.Asoc.Dr)
- Kategoria Doktor Shkencash - 4
- Kategoria MsC - 1

Në programin e studimit MPAB janë angazhuar vetëm pedagogë të brendshëm të UNIKO, nga të cilët:

- Kategoria profesor – (1 Prof. Dr dhe 4 Prof.Asoc. Dr.)
- Kategoria Doktor Shkencash - 4

Fakulteti i Ekonomisë për vitin akademik 2024-2025 ka në përbërjen e tij:


Fakulteti Ekonomik	2024-2025	
	PAE	PAK
Prof.Dr		
Prof.As.Dr	14	
Dr	15	3
MSc	2	1
Total	31	4



	<table><tr><th rowspan="2">Departamenti i Menaxhimit</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>4</td><td></td><td>4</td><td></td></tr><tr><td>Dr</td><td>4</td><td></td><td>4</td><td></td></tr><tr><td>MSc</td><td>1</td><td></td><td>1</td><td></td></tr><tr><td>Total</td><td>9</td><td>0</td><td>9</td><td>0</td></tr></table>	Departamenti i Menaxhimit	2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr					Prof.As.Dr	4		4		Dr	4		4		MSc	1		1		Total	9	0	9	0
Departamenti i Menaxhimit	2023-2024		2024-2025																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr																																			
Prof.As.Dr	4		4																																
Dr	4		4																																
MSc	1		1																																
Total	9	0	9	0																															
	<i>Dokumenti Aneksi 1.29: Personeli akademik dhe ndihmës i FE, 3 vitete e fundit</i> <i>Dokumenti II.19: Pedagogët me kohë të pjesshme në Departmanetin e Menaxhimit</i> <i>Dokumenti Aneksi 13. – Personeli akademik i programit të studimit</i> <i>Dokumenti 2: RVB Master Profesional</i>																																		
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Menaxhimit në këtë program studimi nuk zhvillon praktikë mësimore. Si u përmend dhe më sipër, në vizitën e realizuar në IAL u diskutua gjerësisht mbi këtë kriter dhe rëndësinë specifike që ka për këtë program studimi. <i>Dokumenti Aneksi II.2.: Plani mësimor i programit</i>																																		
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për	Në Vendimin 732 të dt. 1.06.2020 të Departamentit të Menaxhimit, janë përcaktuar koordinatorët e programeve që mbulohen nga Departamenti i Menaxhimit.																																		


programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Detyrat e koordinatorit të programit janë të përcaktuara në Rregulloren e Departmentit të Menaxhimit, dhe në Rregulloren e Programit të Studimit MPAB. <i>Ajo çka do të theksohej pas vizitës në institucion, do të ishte një proaktivitetet më i madh i koordinatores dhe stafit akademik në përmirësimin e programit, përditësimin e tij më kërkesat e kohës dhe tregut të punës.</i> <i>Dokumenti Aneksi II.8: Vendimi i emërimit të koordinatorit të programit</i> <i>Dokumenti 2: RVB Master Profesional</i> <i>Dokumenti II.9: Rregullore e Departamentit</i> <i>Dokumenti II.10: Rregullore e Programit të studimit MPAB</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin "Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi" Departamenti i Menaxhimit i plotëson. Duhet vendosur Praktika Mësimore në program dhe Kategoria e Lëndëve karakterizuese duhet të shkojë brenda kufijve të standardit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Mbështetur në të gjithë dokumentacionin e paraqitur, MPAB karakterizohet: - 1 vit akademik/2 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - ngarkesa mësimore 600 orë në auditor; 900 orë jashtë tij; -forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. Programi strukturohet në: - Kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 1 lëndë, 5 ECTS. 8 % e krediteve (standardi 5%-10%) ;



	- Kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: 5 lëndë, 25 ECTS, 41.6 % e krediteve (standardi 30%- 40%) - Kategoria C - lëndë ndërsipinore 3 lëndë, 15 ECTS – 25 % e krediteve (standardi 20%- 30%) - Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Metodologji kërkimi 6 ECTS, 10% e krediteve (standardi 10%); - Kategoria E – detyrime përmbyllëse: Diploma 9 ECTS, 15% ECTS (standardi 10%- 20%). Gjatë takimit me drejtuesin e Departamentit dhe stafin akademik u theksua domososhmëria për vendosjen e Praktikës Profesionale – kategoria D në program si dhe sistemin e Kategorisë B në kufijtë e standardit. <i>Syllabusët e lëndëve janë formuluar pjesërisht në përputhje me udhëzimet nevojitet të përmirësohet përmbajtja e temave, të detajohet literatura e çdo teme dhe të jetë literaturë e 5 viteve të fundit.</i> <i>Gjithashtu, ekspertët vlerësojnë që duhet të rishikohet forma e vlerësimit duke ju përshtatur qëllimit të MP.</i> <i>Dokumenti Aneksi II.2.: Plani mësimor i programit</i> <i>Dokumenti Shtojca I.32. Programi studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Programet lëndore</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i programit të studimit MPAB përmban të gjithë informacionin mbi ndarjen e lëndëve në semestra, orët në auditor dhe jashtë tij, ndarjen e orëve në leksione e seminare. Semestri I – 750 orë, 360 në auditor dhe 390 jashtë auditorit Semestri II – 750 orë; 240 në auditor dhe 510 jashtë auditorit/ Në total janë 1500 orë në përputhje me standardet. <i>Dokumenti Aneksi II.2.: Plani mësimor i programit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informimi i studentëve në lidhje me kriteret specifike dhe të përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit bëhet përmes një tërësie dokumentacioni që përmban: Rregulloren e UNIKO; Rregulloren e Fakultetit Ekonomik dhe Rregulloren e Departamentit. Drejtuesi i Departamentit u shpreh që është në komunikim të vijueshëm me studentët. <i>Dokumenti Aneksi I.02: Rregullorja e Universitetit</i> <i>Dokumenti Aneksi I.28; Rregullorja e fakultetit</i> <i>Dokumenti Aneksi II.9: Rregullorja e Departamentit</i>

	<i>Dokumenti II.10: Rregullore e Programit të studimit MPAB</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit në MPAB synon të krijojë një formim dhe aftësim në fushat: - Etikë dhe lidërsip; - Sjiellje organizative; - Menaxhim I sistemeve të informacionit; - Vendimarrje; - Qeverisje korporatash dhe biznes ndërkombëtar; - Menaxhim cilësie; - Ekonomiks Menaxherial apo Menaxhim performance - Metoda kërkimi Në takimin në institucion, sugjeruam që programi ka nevojë për një lloj përditësimi dhe zhvillimi duke reflektuar transformimin digjital, inovacionin, marketingun etj. <i>Nga pikëpamja e formatit të syllabuseve duhet të respektohet plotësisht VKM 41 të vitit 2018.</i> Në lidhje me syllabuset e lëndëve duhet evidentuar që nga pikëpamja e literaturës bazë, në një pjesë të syllabuseve konsiderohen leksionet e përgatitura nga pedagogu, tekste në shqip, referimi i literaturës është në pjesën më të madhe i paplotë (mund t'i referohen sistemit APA). GVJ sugjeron që syllabuset të përmirësohen, të përditësohen dhe literatura të rifreskohet. <i>Dokumenti Aneksi II.2.: Plani mësimor i programit</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	<i>Gjatë vizitës në institucion, vlerësuesit theksuan nevojën për realizimin e Studimit të Tregut për këtë program studimi, përdorimin e pyetësorëve, fokus grupeve, takimeve periodike me studentët, takimeve me alumnit, tregun e punës, etj. Programi ka nevojë të përditësohet dhe zhvillohet, gjithçka ka ndryshuar në kontekstin e afërt dhe të largët.</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin "Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë" ka hapësira për përmirësime, përditësime dhe zhvillime, kështu programi ka nevojë për një lloj përditësimi dhe zhvillimi duke</i>



	<i>reflektuar transformimin digjital, inovacionin, marketingun si dhe literaturën e 5 viteve të fundit, sistemin e kategorisë B në kufijtë e standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Referuar Planit Mësimor të programit MPAB lëndët janë kryesisht me 5. ECTS dhe vetëm një lëndë me 6 ECTS. organizuar me një ngarkesë javore 3orë leksion/1 orë seminar. Semestrat kanë nga 30 ECTS dhe në semestrin e dytë është përqëndruar dhe punimi i diplomës, me 9 ECTS. Programi i studimit në MPAB synon të krijojë një formim dhe aftësim në fushat: - Etikë dhe lidërshtip; - Sjellje organizative; - Menaxhim i sistemeve të informacionit; - Vendimarrje; - Qeverisje korporatash dhe Biznes ndërkombëtar; - Menaxhim cilësie; - Ekonomiks Menaxherial apo Menaxhim performance - Metoda kërkimi
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Vlerësuesit e jashtëm gjatë takimit në institucion u dakordësuan me stafin e departamentit për nevojën e një dinamike në programin MPAB, që jo vetëm të reflektojë ndryshimet agresive në tregun lokal të punës, por dhe më gjerë në tregun global. Lëndë si, Sipërmarrja dhe Inovacioni, Marketingu digjital duhen përfshirë, ndërkohë që mund të rishihen përsëritjet BA-MSH apo lëndë të përafërta në program.

(Signature)

Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Vlerësuesit në komunikim me stafin dhe drejtuesit e departamentit sugjeroan domosdoshmërinë e përmirësimit të raportit teori-praktikë, reflektimit në program të përvojave të shkollave ndërkombëtare. Shumë e rëndësishme është të rifreskohen përmbajtjet e lëndëve, të ketë më shumë elementë inovativë, të rifreskojnë literaturën me literaturë të shtëpive me të mira botuese akademike si Pearson apo McGraw Hill; të pasurojnë seminarët me rastet studimore bashkëkohore dhe t'i japin një peshë më të madhe punës në projekte dhe më shumë peshë dhe në vlerësim GVJ sugjeron që departamenti të bëjë një studim më të strukturuar në tregun lokal dhe më gjerë, të përdorë fokus grupet me studentët, me alumnit dhe tregun e punës, si dhe programe të ngjashme në rajon dhe më gjerë për të parë dinamikat e tyre.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi MPAB është hartuar me lëndë dhe module (gjithsej -60 ECTS,) në përputhje të plotë me sistemin europian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve, në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe VKM Nr. 41/viti 2018, dhe si i tillë i jep mundësinë studentëve të transferojnë studimet brenda dhe jashtë Shqipërisë. <i>Dokumenti Aneksi II.2.: Plani mësimor i programit</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Silabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 2: RVB</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Formati i syllabuseve është pjesërisht në përputhje me VKM Nr 41, të vitit 2018, silabuset janë në shqip. <i>Një nga detyrat e theksuara ndaj Zyrës së Kurrikulave dhe Cilësisë në UNIKO është të përputhin plotësisht formatin me VKM 41/2018, si në elementët e përmbajjes dhe të formës.</i> Ekspertët vlerësojnë që formati VKM 41/2018 është i qartë, formati i përdorur në excel nga UNIKO krijon shmangie. Faqja e parë dhe e dytë, nuk përputhet me modelin e VKM, gjithashtu nuk jepet literatura bazë dhe e rekomanduarr dhe metodologjia që përdoret në seminar. <i>Dokumenti Aneksi II.15: Silabuset e lëndëve</i>

Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit MPAB, synon të formojë studentët me njohuri, aftësi dhe qëndrime të domosdoshme për tregun e punës lokal dhe më gjerë. Në silabuset e lëndëve shprehen qartë objektivat dhe rezultatet që lëndët/modulet synojnë të arrijnë dhe gjithë mënyra si ngrihen tematikat javë pas javë dhe si ndërtohen seminarët/ detyrat e kursit dhe rastet studimore është në shërbim të punësimit të tyre dhe angazhimit në tregun e punës dhe për nivelin e tretë të studimeve. Ky program mbulon një spekter të gjerë të temave të rëndësishme për administrimin e biznesit dhe zhvillimin e aftësive menaxheriale. Megjithatë, disa elemente mund të forcohen për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. GVJ detajon si vijon : Sfidat dhe Pikat për Përmirësim: • Mungesa e Lëndëve mbi Sipërmarrjen dhe Inovacionin Tregu i punës në Shqipëri ka një nevojë në rritje për sipërmarrës dhe menaxherë të aftë të përshtaten me teknologjitë e reja dhe tendencat e tregut. Një lëndë mbi Sipërmarrjen dhe Inovacionin do të ishte një shtesë e vlefshme. • Mungesa e Fokusit në Transformimin Digjital dhe Menaxhimin e Projekteve Me rritjen e përdorimit të inteligjencës artificiale dhe transformimit digjital, studentët duhet të kenë njohuri mbi Strategjitë e Transformimit Digjital dhe Menaxhimin e Projekteve për të qenë konkurrues. • Internshipe dhe Partneritete me Bizneset Programi nuk përmend bashkëpunime me kompani ose praktika profesionale. Për të rritur punësueshmërinë e studentëve, universiteti duhet të krijojë marrëveshje me biznese lokale dhe ndërkombëtare për praktika të paguara. • Specializimi në Fushat e Kërkuara nga Tregu Duhet të analizohen sektorët kryesorë të punësimit në rajon, si turizmi, agrobiznesi, sektori financiar dhe administrata publike, dhe të krijohen modulet e specializuara në këto fusha. Rekomandime për Përmirësim 1. Shtimi i Lëndëve mbi Sipërmarrjen dhe Transformimin Digjital
--	---



	- o Propozim: Futja e një lënde mbi Sipërmarrjen dhe Inovacionin dhe një mbi Transformimin Digjital dhe Menaxhimin e Projekteve. 2. Përmirësimi i Lidhjes me Tregun e Punës - o Krijimi i marrëveshjeve me kompani private dhe institucione publike për internshipe dhe punësim të studentëve pas diplomimit. - o Organizimi i forumeve të karrierës dhe ëorkshopeve me ekspertë të industrisë. 3. Zgjerimi i Ofrimit të Zgjedhjeve të Kurseve për Specializim - o Mund të përfshihen kurse të tilla si Menaxhimi i Bizneseve të Vogla dhe të Mesme (SME Management) ose Menaxhimi i Burimeve Njerëzore për studentët që dëshirojnë të specializohen. 4. Fuqizimi i Përdorimit të Analizave dhe Softuerëve të Biznesit - o Shtimi i njohurive mbi softuerët e analizave financiare, CRM dhe ERP, të cilët janë të domosdoshëm në administrimin e biznesit modern. 5. Përmirësimi i Përgatitjes për Tregun Ndërkombëtar - o Zhvillimi i lëndëve në gjuhën angleze për të rritur aftësitë ndërkombëtare të studentëve dhe lehtësuar integrimin e tyre në tregun e huaj të punës.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Megjithatë si është përmendur edhe më lart duhet që programi të përditësohet sipas rekomandimeve me lëndë të cilat janë më afër nevojave të një tregu që ndryshon vazhdimisht. <i>Dokumenti Aneksi II.15: Silabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 2: RVB</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin "Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës" sa i takon kompetencave të ofruara rekomandohet shtimi i lëndëve mbi sipërmarrjen, inovacionin dhe</i>

	<i>transformimin digjital. Nevojitet forcimi i lidhjes me tregun përmes internshipeve dhe partneriteteve me biznese. Sygjerohet gjithashtu zgjerimi i moduleve të specializuara sipas sektorëve me potencial punësimi dhe përdorimi i softuerëve bashkëkohorë të biznesit. Për të rritur konkurrueshmërinë ndërkombëtare, disa lëndë mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Ndonëse në RVB gjejmë të shprehur se departamenti bashkëvepron me aktorët e tregut, këtë bashkëpunim nuk e gjejmë të dokumentuar në tërësinë e dokumentave të paraqitura në portalin e ASCAL-it , për më tepër mungojnë studimet e tregut për këtë program studimi (studimet e paraqitura kanë lidhje me BA dhe janë përgjithësisht të vjetra – studim tregu i vitit 2017-2018 nuk ka asnjë lidhje me tregun shqiptar e më gjerë të 2018). <u>Sugjerimi i vlerësuesve të jashtëm për Departamentin e Menaxhimit të FE-UNIKO, është që krahas diskutimit në Departament, të zhvillojë pyetësorë me studentët që e ndjekin programin, takime periodike me studentët, tregun e punës dhe alumnit, t'i dokumentojë takimet dhe rezultatet e tyre.</u> Gjithashtu, do të ishte e domosdoshme një përjasje ndryshe me studimet master në përputhje me nevojat e studentëve, mbi këtë bazë propozimi ekspertëve për drejtuesit ishte që mësimi të zhvillohet pasdite dhe në fundjavë duke terhequr edhe studentë që punojnë. <i>Dokumenti 2: RVB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.6. Studimet e tregut</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe	Gjatë takimit me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik, ata theksuan qasjen shumë positive që kanë në ndërveprimin me studentët. Plotësimi i kriterëve të standardit kërkon që krahas qasjes institucionale për të vlerësuar përmes pyetësorëve cilësinë e

konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	veprimtarisë akademike dhe administrative të universitetit në përgjithësi, duhet të ndërtohet një metodologji dhe procedurë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies së çdo pedagogu të departamentit dhe të detajohet pyetësi në funksion të lëndëve dhe pedagogëve. Shumë e rëndësishme është që veprimtaritë që bëhen të dokumentohen. <i>Dokumenti 2: RVB</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Në takimin me stafin e Departamentit, u theksua që një vlerë e shtuar për programin në përmirësimin e tij ka prezenca e të ftuarve që vijnë nga biznesi lokal, referenca e një pjese të programit në përvojën e programeve të FE-UT, mundësia që pedagogët kanë përmes shkembimeve Erasmus dhe projekteve ndërkombëtare. Vlerësuesit e jashtëm theksuan nevojën për më shumë proaktivitet, bashkëpunim me industrinë, angazhim në shkrim e zbatim projektesh dhe veçanërisht në kërkim shkencor i cili rrit cilësinë e mësimdhënies të pasuruar me raste empirike nga industria. <i>Dokumenti 2: RVB</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson që në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre" Departamenti dhe Fakulteti duhet të projektojë dhe dokumentojë një sërë veprimtarish që realizon dhe synon të realizojë të shtrira gjatë periudhave të ndryshme kohore, të angazhimit të studentit me programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të	Programi i studimit MPAB vjen për stafin akademik të Departamentit të Menaxhimit si një vijim i studimeve të nivelit të parë, duke synuar formimin dhe aftësimin e mëtejshëm të studentëve të menaxhimit apo programeve të tjera të FE-UNIKO.



studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm u përpoqën të sillnin një këndvështrim ndryshe, ky program master mund të frekuentohet dhe nga studentë të programeve të tjera të UNIKO, por dhe specialistë/profesionistë të tjerë (inxhinierë, psikologë, sociologë, farmacistë, fizioterapistë, artistë, sportistë, etj) të cilët në veprimtarinë e punës së tyre të përditshme kanë domosdoshmëri njohjen dhe aftësimin në menaxhim. Një këndvështrim i tillë, do të duhej të mbështetej nga kërkimi i tregut, dhe nga një qasje ndryshe në përmbajtjen e programit, literaturën e përdorur, marketingun e programit dhe kohën e zhvillimit të procesit mësimor. <i>Dokumenti 2: RVB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Bazuar në <i>Nenin 21 dhe 23 të Rregullores së UNIKO</i> përcaktohen detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore/njësisë bazë në raport me administrimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe të kërkimit. Në Rregulloren e Fakultetit Ekonomik përmes një tërësie kapitujsh paraqiten dispozitat e përgjithshme, programet e studimit, elementet e programeve të studimit, elementët e kontrollit të dijes etj. Në Rregulloren e Departamentit, në <i>kreun e dytë</i> pasqyrohet “Organizimi i departamentit të Adiministrim- Biznesit”; në <i>nenin 2:Funksionet e Departamentit në bashkërendimin e të gjitha veprimtarive mësimore dhe shkencore</i>”, kompetencat e drejtuesit e departamentit dhe kompetencat e grupit mësimor – kërkimor, të koordinatorit të programit. Rregulloret në nivel Universiteti dhe Fakulteti janë në përputhje të plotë me dokumentat kryesore të MAS, veçanërisht ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015. <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e Universitetit</i> <i>Dokumenti 1.28: Rregullorja e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Dokumenti II.9: Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në	Departamenti nxit studentët për t’u bërë pjesë e aktiviteteve të ndryshme, që nga lektorët e ftuar në auditor, thirrjet për shkëmbimet Erasmus, pjesëmarrjen në konferencat e Fakultetit

studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Gjatë takimit me studentët, evidentuam nevojën për një qasje me proaktive të departamentit të menaxhimit, veçanërisht në aspekt të bashkëpunimit me tregun e punës, projektet kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare; shkëmbime Erasmus, programit CEEPUS, etj. <i>Dokumenti 2: RVB,</i> <i>Dokumenti III.3: Aktivitete shkencore të studentëve</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Departamenti ka marrë mbështetje për tre projekte kërkimore nga fondet e brendshme të UNIKO, siç evidentohet edhe në Raportin Vjetor të Departamentit për vitin 2023–2024. Megjithatë, evidentohet nevoja për një qasje më aktive ndaj kërkimit shkencor dhe misionit të tretë të universitetit. Korça, si një nga rajonet me zhvillim të ndjeshëm në Shqipëri, veçanërisht në sektorët e turizmit, agrobiznesit dhe bujqësisë, kërkon mbështetje të strukturuar përmes projekteve kërkimore të orientuara drejt zhvillimit të territorit. Në këtë kontekst, rekomandohet nxitja e bashkëpunimit ndërdepartamental, veçanërisht me fakultete më proaktive si Fakulteti i Bujqësisë, për të ndërtuar sinergji që i përgjigjen dinamikave rajonale dhe rrisin impaktin real të kërkimit. Kjo qasje do të mundësojë zhvillimin e projekteve ndërdisiplinore me ndikim praktik në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës. <i>Dokumenti Aneksi II.27: Raportet vjetore të Departamentit</i> <i>Dokumenti Aneksi II. 17: Aktiviteti Kërkimor Shkencor i DM</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor” departamenti ka hapësirë për t’u angazhuar më shumë në mënyrë cilësore dhe sasiore si në lidhje me kërkimin e projektet, ashtu dhe në lidhje me të gjitha veprimtaritë me studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, është departamenti njësia përgjegjëse që mbështet grupet kërkimore shkencore dhe bashkëvepron me strukturat dhe personat përgjegjës në institucion për kërkimin shkencor, përfshirë këtu Drejtorinë e Projekteve. Nga pikëpamja institucionale, evidentojmë <i>mungesën e Strategjisë së Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit</i>, të cilat do të duhet të drejtojnë 2/3 e veprimtarisë së UNIKO.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Gjatë vizitës në institucion, ekspertët evidentuan që departamenti nuk është pjesë e projekteve evropiane, ndërkufitare (INTERREG) apo të AKKSHI. Gjithashtu, vihet re një nevojë për rritjen e angazhimit të vazhdueshëm në aktivitetet kërkimore-shkencore nga ana e stafit akademik. Nga analiza e botimeve rezultoi se, në disa raste, pas përfitimit të gradës ose titullit shkencor, dinamika kërkimore ka ardhur në rënie. Kjo sugjeron nevojën për të nxitur një kulturë kërkimi të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, në përputhje me objektivat afatgjata të departamentit dhe misionit të tretë të universitetit.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Evidentohet pjesëmarrja në konferenca, por nevojitet shumë më tepër në drejtim të botimeve në revista të indeksuara dhe në Scopus, në përputhje dhe me kriteret ligjore të fitimit të gradave dhe titujve. <i>Gjithashtu, një rekomandim për Departamentin është që bazën e të dhënave të kërkimit shkencor duhet ta mbajë sipas sistemit APA, në mënyrë që të jetë e aksesueshme.</i> <i>Dokumenti Aneksi II.27: Raportet vjetore të Departamentit</i> <i>Dokumenti Aneksi II. 17: Aktiviteti Kërkimor Shkencor i DM</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Ekspertët e jashtëm vlerësojmë që studimi i duhur mbi Tregun e Punës, fokus grupet me studentët që vazhdojnë studimet, këshillimi me aktorë të tregut të punës, gjurmimi i studentëve që diplomohen, etj do të ishin testimi më efikas i suksesit të programit dhe i konkurrueshmërisë së tij. Në kushtet e një tregu të vogël, programi duhet të ketë ose një specifikë lokale të fortë ose një dinamikë dhe qasje që mund ta bënte konkurrent të fortë në tregun e arsimit të lartë. Kjo besojmë mbetet një sfidë e fortë për departamentin dhe fakultetin që ofron programin e studimit në vlerësim.

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	NA
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	NA
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se, në lidhje me standardin “Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor”, Departamenti ka ende nevojë për përmirësim, si në aspektin strategjik, ashtu edhe në dokumentimin formal të veprimtarive kërkimore. Vihet re një qasje jo mjaftueshëm aktive ndaj kërkimit shkencor dhe misionit të tretë të universitetit. Rajoni i Korçës po përjeton një zhvillim të ndjeshëm në sektorë kyç si turizmi, agrobiznesi dhe bujqësia, të cilët kërkojnë mbështetje përmes kërkimit aplikativ dhe shkencor. Në këtë kontekst, rekomandohet fuqizimi i bashkëpunimit ndërdepartamental, veçanërisht me fakultete më të angazhuara në kërkim, si Fakulteti i Bujqësisë, për të ndërtuar sinergji që i përgjigjen dinamikave rajonale. Gjithashtu, nga analiza e botimeve shkencore, vihet re se në disa raste pas përfitimit të gradës apo titullit shkencor, angazhimi në kërkim ka ardhur në rënie, çka nënvizon nevojën për të nxitur një kulturë kërkimi të vazhdueshme, në përputhje me objektivat afatgjata të departamentit dhe zhvillimin e rolit të tij në komunitet.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL, për programin e studimit në shqyrtim, vërehet se UNIKO ka përfshirë të gjitha format e mësimdhënies e mësimnxënies siç janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit/kuize, projektet ,të paraqitura në planin mësimor dhe në silabuset përkatëse. Këto elementë janë të dokumentuara dhe paraqitur pranë ASCAL. <i>Dokumenti Aneksi II.15 2024-2025 Programet Lendore</i> <i>Dokumenti Aneksi II.13 Kriteret Vlerësimi-Ekuivalentimi MP</i> <i>Dokumenti Aneksi II.6 Udhezues Punim Diplome</i> <i>Dokumenti Aneksi III.4 Format Vlerësimi Punim Diplome</i> <i>Dokumenti Aneksi III.1 Model Pyetësori Studentor</i> <i>Dokumenti Aneksi II.2 Plani Mesimor</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10 Rregullore Prog. Stud. MP Administrim Biznesi</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve,	Siç është përmendur më sipër, përveç metodave tradicionale të mësimdhënies në auditor, Universiteti “Fan S. Noli” (UNIKO), dhe më konkretisht njësi bazë – Departamenti i Menaxhimit – ka

Ecole

duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	parashikuar forma të kontrollit të vazhduar të njohurive, të ndara në mënyrë të balancuar si më poshtë: • 10 pikë – Kolokiume • 10 pikë – Diskutime në klasë • 10 pikë – Projekte individuale ose në grup • 70 pikë – Provim final Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vlerëson se, duke marrë parasysh natyra praktike dhe profesionale e këtij cikli studimi, njësia bazë duhet të ndërmarrë më shumë përpjekje për të ofruar forma më fleksibël të kontrollit të njohurive, të cilat përfshijnë: • Vlerësim me bazë projekte reale të zhvilluara në bashkëpunim me institucione ose biznese; • Prezencë e vlerësimit ndërdisiplinor, që lidhet me kompetenca praktike; • Feedback i rregullt dhe formativ, për të ndihmuar zhvillimin profesional të studentëve gjatë gjithë semestrit. Këto forma synojnë të rrisin cilësinë e procesit mësimor dhe të përshtaten më mirë me qëllimin e programit Master Profesional, duke forcuar lidhjen midis njohurive teorike dhe aftësive praktike të nevojshme në tregun e punës. <i>Dokumenti Aneksi II.15 2024-2025 Programet Lëndore</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL dhe nga diskutimet me stafin akademik vërehet se stafi akademik inkurajohet dhe mbështetet të zhvillohet dhe përmirësojë cilësinë e mësimdhënies duke u angazhuar në aktivitete të ndryshme dhe projekte ndërkombëtare që do çojnë në përmirësimin e kurrikulës dhe teknikave të mësimdhënies. Nga takimi me stafin vlerësohet edhe eksperiencia e marrë nga bashkëpunimet . <i>Dokumenti Aneksi II.15 2024-2025 Programet Lëndore</i> <i>Dokumenti Aneksi II.13 Kritere Vlerësimi-Ekivalentimi MP</i> <i>Dokumenti Aneksi II.6 Udhezues Punim Diplome</i> <i>Dokumenti Aneksi III.4 Format Vlerësimi Punim Diplome</i> <i>Dokumenti Aneksi III.1 Model Pyetësori Studentor</i> <i>Dokumenti Aneksi II.2 Plani Mesimor</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10 Rregullore Prog. Stud. MP Administrim Biznesi</i>

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Gjatë viteve të fundit, stafi i Departamentit të Menaxhimit ka shfaqur një nivel të caktuar angazhimi në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë bashkëpunime me institucione të huaja, si dhe pjesëmarrje në projekte mobiliteti që synojnë përmirësimin e cilësisë mësimore dhe përfshirjen në aktivitete kërkimore. Gjithashtu, është evidentuar përfshirja e disa anëtarëve të stafit në mobilitete Erasmus+, në kuadër të marrëveshjeve me universitete partnere europiane. Këto mobilitete kanë shërbyer për realizimin e leksioneve të shkurtra në institucione të huaja, trajnime pedagogjike dhe shkëmbim eksperiencash akademike, si dhe për të thelluar bashkëpunimet në fushën e menaxhimit dhe administrimit të biznesit. Në fushën e kërkimit shkencor, janë evidentuar disa angazhime përmes publikimeve në revista akademike, prezantimeve në konferenca dhe pjesëmarrjes në studime kërkimore. Megjithatë, siç u theksua edhe më sipër, duke marrë parasysh natyrën profesionale të programit të studimit, rekomandohet që njësia bazë të tregojë më shumë proaktivitet dhe përfshirje të drejtpërdrejtë në projekte aplikative dhe kërkime të lidhura me nevojat konkrete të tregut të punës, si dhe të zgjerojë rrjetin e bashkëpunimeve ndërkombëtare. Kjo do të mundësonte jo vetëm rritjen e cilësisë akademike, por edhe forcimin e lidhjes mes teorisë dhe praktikës në përgatitjen profesionale të studentëve. <i>Dokumenti Aneksi_II.17_Aktiviteti kerkimor-shkencor_DM.pdf</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita e kryer në IAL, vërehet se UNIKO ka hartuar udhëzues të posaçëm dhe ka zhvilluar mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë proces janë të përfshirë pedagogët edhe studentët. Hartimi i udhëzuesve dhe ngritja e strukturave përkatëse është rregulluar nëpërmjet Statutit të institucionit, Rregullores së institucionit, Rregullores së Senatit Akademik, Udhëzimit për miratimin e teksteve mësimore në nivel të Njesisë Bazë, si dhe Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, reflektuar në Nenin 3, pika 2 për ngritjen e strukturës përkatëse si dhe në Nenin 6, pika 8, për monitorimin e cilësisë. Monitorimi i cilësisë së



	mësimdhënies pasqyrohet në raportet e vlerësimit të kryer nga NJSBC-ja. <i>Dokumenti Shtojca 1.1 – Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.2 – Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.5 – Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e DKVI</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.6 – Marrëveshja me RASH për Sistemin Elektronik PITAGORA</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.11 – Rregullore e Senatit Akademik</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.12 – Udhëzim për Procedurat e Miratimit, Botimit dhe Shpërndarjes së Teksteve Mësimore në Nivel Njësie Bazë</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.16 – Manuali i Cilësisë së UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15 – 2024-2025 Programet Lendore</i> <i>Dokumenti Aneksi II.18 – CV Stafit Akademik</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu, monitorimi i cilësisë është rregulluar nëpërmjet Manualit të Cilësisë i cili përcakton hapat, detyrat dhe strukturat për garantimin e cilësisë në mësimdhënie. Studentët përfshihen në këtë proces nëpërmjet pyetësorëve. Përfshirja e studentëve në monitorim kryhet edhe nëpërmjet përfaqësimit të një studenti në NJSBC. Publikimi i të dhënave të monitorimit të cilësisë dhe aspekteve të tjera në raport me studentët dhe jo vetëm është rregulluar nëpërmjet Manualit të sistemit elektronik Pitagora. Gjithashtu, sipas stafit të UNIKO që morën pjesë në takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion të dhënat e nxjerra nga aktivitetet monitoruese për cilësinë por jo vetëm publikohen në faqen zyrtare të institucionit. <i>Dokumenti Shtojca 1.1 – Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.2 – Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.5 – Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e DKVI</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.6 – Marrëveshja me RASH për Sistemin Elektronik PITAGORA</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.11 – Rregullore e Senatit Akademik</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.12 – Udhëzim për Procedurat e Miratimit,</i>

	<i>Botimit dhe Shpërndarjes së Teksteve Mësimore në Nivel Njësie Bazë</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.16 – Manuali i Cilësisë së UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15 – 2024-2025 Programet Lendore</i> <i>Dokumenti Aneksi II.18 – CV Stafit Akademik</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në gjetjet e paraqitura në pjesën përshkrimore, vërehet se institucioni ka ndërmarrë hapa për të garantuar procesin e të nxënësve dhe zhvillimin profesional e shkencor të studentëve, duke aplikuar qasje me në qendër studentin dhe metoda bashkëkohore mësimdhënieje. Megjithatë, niveli i përmbushjes së standardit kërkon një vlerësim të mëtejshëm për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe ndikimin konkret të këtyre praktikave në rezultatet e të nxënësve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve janë të përcaktuara qartë në dokumentet rregullative të Institucionit, konkretisht në: • Shtojca 1.1 – Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, ku përcaktohen parimet bazë të organizimit akademik dhe garantimit të cilësisë në procesin mësimor. • Shtojca 1.2 – Rregullorja e UNIKO, Kreu VII (nenet 76–100), e cila përshkruan në mënyrë të detajuar procedurat e vlerësimit të studentëve, duke përfshirë format e vlerësimit, afatet, mënyrën e administrimit të provimeve, si dhe të drejtën e studentit për ankim. Këto dokumente janë publike dhe të aksesueshme për studentët përmes faqes zyrtare të Universitetit dhe platformës digjitale të përdorur nga institucioni.

	<i>Dokumenti Aneksi II.10 Rregullore Prog. Stud. MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15 2024-2025 Programet Lendore</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Për më tepër, çdo lëndë përmban syllabusin përkatës, i cili u shpërndahet studentëve në fillim të semestrit dhe ku pasqyrohen: • format e vlerësimit (provim final, punime kursi, testime të ndërmjetme, prezantime, etj.), • peshat përkatëse të secilës komponentë në vlerësimin përfundimtar, • kriteret për përfitimin e notës. Njohja dhe transparencja e këtyre procedurave sigurohen përmes orientimit të studentëve në fillim të ciklit të studimeve dhe nga komunikimi i rregullt që zhvillohet nga stafi pedagogjik gjatë çdo semestri. Kjo qasje synon të garantojë barazi, objektivitet dhe qartësi në procesin e vlerësimit. <i>Dokumenti Aneksi II.10 Rregullore Prog. Stud. MP Administrim Biznesi</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në formë dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në formë të ndryshme, duke i dhënë studentit mundësinë të demonstrojë në mënyrë të plotë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Sipas syllabuseve të lëndëve, të cilat shpërndahen dhe shpjegohen në fillim të çdo semestri, janë të përcaktuara: • format e vlerësimit (provime me shkrim, punime praktike, detyra të ndërmjetme, prezantime, pjesëmarrje aktive), • raporti i peshës mes vlerësimit të vazhduar dhe provimit final. Aktualisht, në shumicën e lëndëve aplikohet raporti 30% për vlerësimin gjatë semestrit dhe 70% në provimin final, çka ndihmon në testimin përfundimtar të njohurive, por kërkon rishikim për të siguruar një shpërndarje më të ekuilibruar të ngarkesës vlerësuese dhe për të inkurajuar angazhim të qëndrueshëm të studentit gjatë gjithë semestrit. Praktika më bashkëkohore në arsimin e lartë mbështet vlerësimin e vazhduar (continuous assessment) si një formë më gjithëpërfshirëse dhe zhvilluese për studentin. Në këtë kuadër, sygjerohet që programet e studimit të rishikojnë raportin aktual dhe të vendosin një strukturë më të balancuar, për shembull 40/60 ose 50/50, në varësi të natyrës së lëndës.





	Ky rishikim do të kontribuonte në: • përmirësimin e cilësisë së të nxënit, • identifikimin më të hershëm të vështirësive të studentit, • dhe ndërtimin e një procesi vlerësues më të drejtë dhe formues. <i>Dokument Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'</i> <i>Dokument Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO (Kreu VII, nenet 76–100)</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullore e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2022-2023 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2023-2024 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2024-2025 Programet Lëndore</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe analizën e zhvilluar në pjesën përshkrimore, rezulton se kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të dokumentuara në aktet rregullative të institucionit. Studentët njihen me to përmes syllabus-eve, udhëzuesve dhe platformës elektronike Pitagora. Vlerësimi në shumicën e rasteve ndjek një strukturë të standardizuar, me një raport tipik 30% vlerësim i vazhduar dhe 70% provim final, i cili siguron një trajtim të barabartë dhe të kontrolluar të studentëve. Megjithatë, GVJ sugjeron që në vijimësi të konsiderohet rritja e fleksibilitetit në ndarjen e peshës së komponentëve të vlerësimit, në varësi të natyrës së lëndës (teorike, praktike, kërkimore). Një qasje më e balancuar, si për shembull raporti 40/60 ose 50/50, do të nxiste një angazhim më të qëndrueshëm të studentëve gjatë gjithë semestrit dhe do të mbështeste zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe të zbatimit praktik të dijes.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit dhe të FE në UNIKO, përcakton parimet e kriterëve të vlerësimit për lëndën, si edhe tabelën e vlerësimit të notave brenda kornizave kohore të dedikuara sipas karakteristikave të lëndës. Pavarësisht specifikave të lëndës apo fokusit të pedagogut në vlerësimin e komponentëve të caktuar, tesimi i njohurive bëhet gjatë të gjithë lëndës duke u bazuar mbi elementë të ndyshëm siç janë pjesmarrja aktive, përgatitja e projekteve apo prezantimeve. Kjo shihet edhe në shpërndarjen e vlerësimit përfundimtar në disa zëra, çfarë përcaktohet qartë në rregullore duke u harmonizuar me kërkesat e lëndës, dhe konkretisht: a) detyra specifike sipas llojit të lëndës; b) provimi përfundimtar apo detyra kursi; c) pjesëmarrje aktive gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës. Kjo mënyrë vlerësimi krijon mundësinë për të vlerësuar progresin e arritur nga studentët dhe i mundëson atyre të evidentojnë mangësitë e paraqitura. Megjithatë si u përmend më sipër nevojiten më shumë komponentë vlerësimi përgjatë semestrit. <i>Dokumenti Aneksi II.10 Rregullore Prog. Stud. MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokumenti Aneksi I.28 Rregullore FE.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Provimet zhvillohen si në formatin e printuar ashtu edhe në atë elektronik, pasi institucioni ka vënë në dispozicion të pedagogëve sisteme elektronike të vlerësimit të cilat sigurojnë aksesin e studentëve në informacionin e nevojshëm siç janë notat, frekuentimi etj., por edhe sigurojnë transparencën e vlerësimit dhe shmangin format e mundshme të abuzimit. <i>Dokument Aneksi .1.1 Statuti i UK.pdf.</i> <i>Dokument Aneksi .1.2 Rregullorja e UK.</i> <i>Dokument Aneksi.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora.</i> <i>Dokument Aneksi.1.20 Rregullore e Bordit të Amdinistrimit.</i> <i>Dokument Aneksi .2.5 Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar bëhet duke zbatuar rregulloret dhe kërkesat e silabuseve përkatës për çdo lëndë, dhe rregulloren e IAL dhe zhvillohet duke marrë parasysh vlerësimet e pjesshme dhe ato përfundimtare të secilit element të testimit të lëndës siç u përmend më sipër. Për një transparencë sa më të plotë, përqindjet e vlerësimit për çdo element vendosen në një rubrikë të veçantë të syllabusit, si edhe u shpjegohet studenteve në fillim të çdo lënde.



	Komisionet e provimeve të përbërë nga dy pedagogë dhe titullari i lëndës, ngrihen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit në përputhje me Statutin e Universitetit, rregulloren e provimeve dhe udhëzimin përkatës të Dekanit të Fakultetit ekonomik (neni 34, Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit.. <i>Dokument Aneksi 1.2 Rregullorja e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO)</i> <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.9 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (DM)</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogët ofrojnë sugjerime dhe feedback për secilin nga elementët e vlerësimit të studentit. Vlerësimit të studentit i bashkangjitet një feedback nga ana e pedagogut dhe përcillet përmes email apo komunikimit direkt të secilit student me pedagogun për të sqaruar arsyet e vlerësimit, ndërsa studentët inkurajohen që të shprehin ankesat e tyre për vlerësimin. Studentët marrin feedback gjatë gjithë vitit lidhur me përparimin e tyre përse i takon përputhshmërisë së performancës së tyre akademike me kërkesat e lëndës <i>Dokument Aneksi 1.2 Rregullorja e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO)</i> <i>Dokument Aneksi I.28 . Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.9 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (DM)</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	UNIKO përcakton në "Kodin e Etikës" dispozitat për shkeljet disiplinore, siç mund të jetë kopja, rastet e plagjiaturës apo format e tjera të mashtrimit, rastet e të cilave trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Plagjiatura sqarohet gjerësisht nga pedagogët për studentët gjatë zhvillimit të lëndës, në mënyrë që studentët të informohen si duhet se çfarë përbën plagjiaturë dhe si mund të bëhen citimet e materialeve shkencore. Sikundër u theksua më lart rregulloret në nivel IAL dhe në nivel programi përcaktojnë masat që marrin pedagogët në mënyrë që procedura e provimit të jetë e pakorruptueshme dhe si të zbatojnë rregulloren e universitetit për të gjithë ata studentë që shkelin etikën



	akademike. GVJ vlerëson se në nivel institucional ekziston një kuadër i qartë normativ dhe etik për mbrojtjen e integritetit akademik, dhe se përgjegjësitë janë të ndara mes strukturave drejtuese dhe stafit pedagogjik. Megjithatë, mungesa aktuale e një sistemi elektronik për zbulimin e plagjiaturës mbetet një mangësi që kërkon adresim. Prandaj, GVJ rekomandon: • përshejtimin e angazhimeve për sigurimin e softuerit anti-plagjiaturë përmes projekteve në zhvillim, • intensifikimin e sensibilizimit të studentëve mbi pasojat e plagjiaturës në fillim të çdo cikli, <i>Dokument Aneks 1.2 Rregullorja e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO)</i> <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.9 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (DM)</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Shtojca 1.19 Kodi i Etikës së UNIKO</i> <i>Dokument Aneksi III.2 Modele Procesverbali</i> <i>Dokument Aneksi III.4 Format Vlerësimi për Punimin e Diplomës</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Si u përmend më lart ekzistojnë forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve duke patur parasysh objektivat didaktike të lëndës me një sistem prej 10 notash, ndërsa nota më e ulët kaluese është 5. Rregullorja e UNIKO përcakton afatet e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore, jo më shumë se 8 ditë nga data e provimit përfundimtar - pasi më parë sekretaria ka informuar pedagogët lidhur me këto data, që në fillim të vitit akademik. Në provimet me gojë nota ofrohet direkt pas përfundimit të provimit. Ky informacion është i pasqyruar në kalendarin akademik, i cili publikohet edhe në faqen e internetit të universitetit. <i>Dokument Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO)</i> <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.9 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (DM)</i>

	<i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët njihen me notën përpara se kjo të dorëzohet në sekretari dhe mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me vlerësimin si edhe të kërkojnë të takohen me pedagogun për të marrë një arsyetim lidhur vlerësimin me notë. Studentët kanë të drejtën e ankimit për notën brenda 5 ditëve nga marrja e përgjigjes së provimit pranë pedagogut të lëndës, i cili shqyrton nëse ka patur ndonjë gabim në korrigjimin e provimit, dhe në rast se studenti nuk bindet për argumentimin ka të drejtë të ankohet pranë dekanatit që ngre një komision të posaçëm vlerësimi. Studentët ndjekin një procedurë të veçantë për ankimimet në të gjitha nivelet dhe për të gjitha strukturat duke përfshirë si anën akademike ashtu edhe atë logjistike apo administrative. Studentët kanë të drejtë të ankimojnë notën fillimisht me pedagogun e lëndës dhe nëse pedagogu nuk e gjykon me vend të rishikojë notën, atëherë studenti i drejtohet koordinatorit të Departamentit, për të përfunduar më pas me komisionin vlerësues që ngrihet në përputhje me procedurat për këtë ankimim, të cilat janë të sanksionuara në Dokument Shtojca 1.2 – RREGULLORJA E UNIKO, konkretisht Kreu VII (nenet 76–100) që i referohet procedurave të vlerësimit dhe administrimit të provimeve. Procedurat janë transparente dhe mund të ndiqen në çdo hap si nga studenti ashtu edhe nga sekretaria, e cila dokumenton dhe arkivon çdo hap duke përfshirë edhe raportin përfundimtar të aprovuar nga dekanati. <i>Dokument Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO)</i> <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.9 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (DM)</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga	Rregullorja e UNIKO (Dokument Shtojca 1.2), në Kreun VII (nenet 76–100), përcakton mekanizmat e vlerësimit, të drejtën e studentit për të bërë ankesë ndaj rezultatit të provimit, si dhe hapat proceduralë për rishikimin e vlerësimit nga Komisioni i

EROT

komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<i>Vlerësimit, e më pas, në rast nevojë, nga një komision i posaçëm i ngritur për shqyrtim të mëtejshëm.</i> • <i>Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (Dokument ANEKSI_I.28) dhe</i> • <i>Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (Dokument ANEKSI_II.9)</i> <i>e konkretizojnë këtë proces në nivel njësie bazë, duke siguruar që çdo kërkesë të trajtohet me objektivitet, konfidencialitet dhe brenda afateve të përcaktuara.</i> • <i>Gjithashtu, në Rregulloren e Programit të Studimit (Dokument ANEKSI_II.10) janë të përfshira saktësisht referencat për mënyrën e komunikimit të rezultatit dhe të drejtës për ankim, si dhe afatet për paraqitjen e tij.</i> <i>E gjithë procedura është e dokumentuar dhe arkivohet në mënyrë të rregullt, sipas standardeve të përcaktuara në Manualin e Cilësisë së UNIKO (Shtojca 1.16), duke siguruar gjurmueshmëri dhe transparencë për të gjitha palët e përfshira.</i>			
Konkluzione	<i>IAL UNIKO ka krijuar një kuadër të plotë aktesh rregullatore dhe procedurash të brendshme që garantojnë një proces vlerësimi të drejtë, objektiv dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. Rregulloret përkatëse të Universitetit, Fakultetit, Departamentit dhe Programit të Studimit MP në Adminstrim Biznes. Megjithatë, GVJ vlerëson se mungesa e një softueri të dedikuar anti-plagjiaturë mbetet një boshllëk teknik, që ndikon në mekanizmat e garantimit të origjinalitetit në punimet e studentëve. Prandaj, rekomandohet pajisja e institucionit me një sistem verifikimi elektronik anti-plagjiaturë, i cili do të përforconte më tej standardet e ndershmërisë akademike dhe do të mbështeste rritjen e cilësisë së kërkimit dhe të punimeve përfundimtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi”, me kohëzgjatje dy semestra dhe 60 kredite, ofron një

thelimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	bazë të qëndrueshme njohurish teorike dhe aplikative në fushën e menaxhimit. Lëndët përfshijnë: <i>Etika në Biznes, Qeverisja e Korporatave, Menaxhimi i Cilësisë, Marrja e Vendimeve Menaxheriale, Liderhip, Sjellje Organizative, Sistemet e Menaxhimit të Informacionit, Menaxhimi i Performancës, Ekonomiks Menaxherial, Metodologji Kërkimi dhe Mikroteza</i>. Programi vendos theksin te formimi teorik dhe aftësitë e analizës menaxheriale, të integruara përmes lëndës së Metodologjisë së Kërkimit dhe mikrotezës. Megjithatë, nuk përfshin një praktikë të strukturuar profesionale (kategoria D), që do t'i lejonte studentëve të përballeshin drejtpërdrejt me situata reale në tregun e punës. Rekomandohet që në të ardhmen, programi të integrojë një komponent të formalizuar të praktikës profesionale në bashkëpunim me biznese, organizata apo institucione publike, për të forcuar përgatitjen praktike të studentëve dhe për të përmbushur më plotësisht profilin profesional të diplomës. <i>Dokument Aneksi II.2 Plani Mësimor i Programit MP në Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2022-2023 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2023-2024 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2024-2025 Programet Lëndore</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive teknologjike përmes lëndës “Sistemet e Informacionit të Menaxhimit”, ndërsa aftësitë humane, sociale dhe të komunikimit përforcohen në lëndë si Liderhip, Sjellje Organizative, Menaxhimi i Performancës dhe Etika në Biznes. Ndërveprimi dhe aftësitë për komunikim profesional nxiten gjithashtu në kuadër të punës kërkimore dhe mikrotezës, e cila synon të përmbledhë njohuritë e fituara në një kontekst të aplikueshëm. Megjithatë, gjatë takimit me stafin e angazhuar në program u ngrit diskutimi mbi përshtatshmërinë e lëndës “Metodologji Kërkimi” me natyrën praktike të një masteri profesional, pasi nuk u vërejt një qasje e qartë që ta lidhte këtë lëndë me nevojat praktike të studentëve. Gjithashtu, struktura e mikrotezës në disa raste i afrohet formës së një teze shkencore, çka mund të mos i shërbejë qëllimit kryesor të këtij programi.

	Sygjerohet që lënda “Metodologji Kërkimi” të rishikohet për të reflektuar më qartë orientimin profesional të programit, duke u fokusuar në metoda të aplikuara dhe analiza rastesh konkrete (case studies). Po ashtu, mikrotezat e studentëve duhet të udhëzohen drejt zgjidhjes së problemeve praktike, në bashkëpunim me subjekte reale nga fusha e administrimit të biznesit. <i>Dokument Aneksi II.2 Plani Mësimor i Programit MP në Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2022-2023 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2023-2024 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2024-2025 Programet Lëndore</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë e përcaktuara në programin e studimit dhe syllabuset analizohen në përfundim të çdo lënde. Personeli akademik identifikon çështjet kryesore dhe orienton studentët për aplikimin e tyre në detyrat përmbyllëse, përfshirë mikrotezën. <i>Dokument Aneksi II.2 Plani Mësimor i Programit MP në Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2022-2023 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2023-2024 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi II.15 2024-2025 Programet Lëndore</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e	Mësimdhënia në programin Master Profesional në “Administrim Biznesi” realizohet mbi bazë kompetencash, duke ndërthurur njohuritë teorike me elementë praktikë. Stafi akademik mbështet diskutimet, punën në grup, interpretimin e rasteve konkrete dhe zgjidhjen e problemeve, duke krijuar një klimë që nxit mendimin kritik, zhvillimin e ideve dhe orientimin e studentëve drejt zbatimit të njohurive në kontekste reale. IAL ka vendosur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me subjekte të sektorit privat dhe institucione të tjera, të cilat përfaqësojnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e praktikës profesionale. Megjithatë, aktualisht nuk është e integruar një praktikë e detyrueshme në strukturën e programit, ndaj realizimi dhe formalizimi i kësaj praktike mbetet thelbësor për përmbylljen e plotë të këtij kriteri.




shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<i>Dokument Aneksi I.33 Marrëveshje Institucionale</i> <i>Dokument Aneksi I.34 Marrëveshje Bashkëpunimi</i> <i>Dokument Aneksi I.35 Marrëveshje Bashkëpunimi (DM)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga Dokumenti Aneksi III.3 – Aktivitetet Shkencore të Studentëve, rezulton se studentët e Fakultetit Ekonomik janë përfshirë në një sërë aktivitete jashtë auditorit, përfshirë: ëorkshope, konferenca studentore dhe shkencore, tryeza të rrumbullakta, leksione të hapura, simpoziume dhe vizita studimore, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave ndërdisiplinore, rritjen e ndërgjegjësimit për sfidat aktuale të menaxhimit dhe nxitjen e mendimit kritik. Aktivitetet e zhvilluara kanë trajtuar tematika aktuale si transformimi digjital, inovacioni në biznes, privatësia e të dhënave, siguria në rrjete, roli i gruas në shoqëri, dhe orientimi drejt startupeve, duke përfshirë edhe bashkëpunime me aktorë nga sektori privat dhe publik. Këto veprimtari mbështesin formimin praktik dhe komunikues të studentëve, si dhe krijimin e lidhjeve të tyre me tregun e punës. Megjithatë, GVJ vëren se këto aktivitete nuk janë të dokumentuara në mënyrë të dedikuar për programin Master Profesional në “Administrim Biznesi”, edhe pse gjatë takimeve me stafin u konfirmua realizimi i disa leksioneve të hapura me përfaqësues nga sektori i SME-ve. Këto aktivitete, të vlefshme për zhvillimin profesional të studentëve, duhet të identifikohen, dokumentohen dhe referencohen qartë si pjesë e këtij programi studimit. GVJ rekomandon që Departamenti i Menaxhimit të rregjistrojë dhe raportojë sistematikisht aktivitetet e realizuara specifikisht për programin MP në “Administrim Biznesi”, duke përfshirë leksionet e hapura, trajnimet dhe seminarat me partnerë institucionalë, për të siguruar gjurmueshmëri dhe për të përmbushur standardin në mënyrë të plotë. <i>Dokument Aneksi III.3 Aktivitetet Shkencore të Studentëve</i> <i>Dokument Aneksi VI.2 Programi i Veprimtarive</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara	Institucioni inkurajon përfshirjen e studentëve në aktivitete kërkimore dhe ide inovative përmes konferencave studentore, ëorkshopeve dhe leksioneve të hapura. Përfshirja e studentëve

kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	në përgatitjen e mikrotezave dhe projekteve kërkimore në bashkëpunim me pedagogët është evidente. Megjithatë, mbështetja financiare direkte për projektet e studentëve nuk është e strukturuar si mekanizëm i qëndrueshëm, ndaj rekomandohet të krijohen forma specifike të mbështetjes financiare për nisma studentore dhe kërkim të aplikuar.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit kontribuon në zhvillimin e aftësive krijuese dhe zbatuese të studentëve, si dhe në thellimin e kompetencave profesionale dhe kërkimore. Megjithatë, për përmbushje të plotë të standardit, rekomandohet forcimi i mbështetjes institucionale për praktiken si dhe mbështetjes financiare për projektet studentore inovative dhe kërkimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit parashikohet që njësia bazë të ndjekë një procedurë të posaçme për studentët që japin provimin final ose mbrojnë diplomën. Anëtarët e stafit akademik depozitojnë pranë përgjegjësit të njësisë bazë DM një grup pyetjesh (fond pyetjesh) për çdo lëndë/modul të tyre me qëllim që studentët të orientohen paraprakisht në lidhje me literaturën që duket të lexojnë për t'u përgatitur për provimin final. <i>Dokument Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO)</i> <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.9 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (DM)</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion	Pedagogët por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse.



informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Ky informacion përfshin si detyrimet akademike që studentët kanë për përmbylljen e programit. Tema dhe udhëheqësit miratohen nga Departamenti i Menaxhimit pas konsultimeve me studentët. <i>Dokument Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO)</i> <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.9 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (DM)</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit, parashikohet që njësia bazë të ndjekë një procedurë të posaçme për studentët që japin provimin final ose mbrojnë diplomën. Anëtarët e stafit akademik depozitojnë pranë përgjegjësit të njësisë bazë një grup pyetjesh (fond pyetjesh) për çdo lëndë/modul të tyre me qëllim që studentët të orientohen paraprakisht në lidhje me literaturën që duket të lexojnë për t'u përgatitur për provimin final. <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.9 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (DM)</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë	Institucioni i Arsimit të Lartë "Fan S. Noli" (UNIKO), përmes Departamentit të Menaxhimit në kuadër të Programit të Studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi", ka ndërtuar një sistem të qartë dhe funksional për menaxhimin dhe vlerësimin e punimit përmbyllës (mikrotezës). Udhëheqësi i mikrotezës mbështet studentin në përzgjedhjen e temës, ndërtimin metodologjik, analizën e të dhënave dhe përgatitjen e përmbajtjes përfundimtare. Vendimi për paraqitjen e punimit përpara komisionit merret nga udhëheqësi, pasi të sigurohet cilësia akademike dhe përmbushja e objektivave të mikrotezës. Si praktikë e mirë, institucioni ka zbatuar një Format të strukturuar vlerësimi të mikrotezës, i cili përfshin 8 kriterë thelbësorë, si:



për t'u paraqitur para komisionit.	• rëndësia dhe aktualiteti i temës, • objektivat dhe qartësia kërkimore, • përzgjedhja dhe zbatimi i metodologjisë, • koherenca e përmbajtjes, • analiza dhe interpretimi i rezultateve, • konkluzionet dhe përputhja me objektivat, • organizimi i punimit dhe stili i shkrimit, • dhe referencat bibliografike. Secili kriter vlerësohet me notë nga 4 deri në 10, dhe formati plotësohet si nga udhëheqësi i mikrotezës, ashtu edhe nga oponenti, duke mundësuar një proces transparent, të dokumentuar dhe të balancuar të vlerësimit. <i>Dokument Aneksi II.6 Udhëzuesi për Punimin e Diplomës</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi III.4 Format Vlerësimi për Punimin e Diplomës</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqesit i asistojnë studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit të dizertacionit. Përveç vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda institucionit për hartimin e dizertacionit, <i>Dokument Aneksi II.6 Udhëzuesi për Punimin e Diplomës</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi III.4 Format Vlerësimi për Punimin e Diplomës</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Tema e diplomës dhe provimi vlerësohen nga komisioni prej jo më pak se dy anëtarësh i ngritur dhe aprovuar për këtë qëllim sipas rregullores së departamentit/programit të studimit/ rregullores së UNIKO me një sistem notash nga 4-10 . Komisioni jep feedback mbi vlerësimin e bërë me shkrim. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i notës 5. <i>Dokument ANEKSI II.6 – Udhëzuesi për Punimin e Diplomës</i> <i>Dokument ANEKSI II.10 – Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i>

	<i>Dokument ANEKSI III.4 – Format Vlerësimi për Punimin e Diplomës</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	IAL në rregulloren e institucionit ofron udhëzime të qarta për pajisjen e studentit me diplomën MP në “Administrim Biznesi”. Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën e ciklit të dytë të studimeve dhe me suplementin e diplomës. Forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuara nga MAS dhe Qendra e Shërbimit të Studentëve (QSHA), dhe rregjistrohen pranë Zyrës së Rregjistrimit, ndërsa dorëzimi i tyre bëhet në një ceremoni të veçantë. <i>Dokument Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit “Fan S. Noli” (UNIKO)</i> <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullorja e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.9 Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit (DM)</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e regjistrat themeltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike. Kjo sekretari ngarkohet edhe me mbajtjen e kartelës së studentit ku pasqyrohen kreditet e akumuluar dhe aktiviteti akademik. Dosjet personale të studentëve pas diplomimit ruhen në arkivin qendror të universitetit duke respektuar normat në fuqi për privatësinë por edhe rregulloren e këtij arkivi. <i>Dokument Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK</i>			
Konkluzione	IAL ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga udhëheqësi i tezës së diplomës. IAL e përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë si diplomën ashtu edhe suplementin e diplomës.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.6


Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Programi i Studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi”, i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit në UNIKO, nuk përfshin në strukturën e tij një modul të dedikuar për praktikë profesionale. Nga shqyrtimi i ANEKSI II.2 – Planit Mësimor dhe ANEKSI II.15 – Programeve Lëndore, rezulton se nuk është e parashikuar një lëndë apo aktivitet i vlerësuar me kredite që lidhet me zhvillimin e praktikës në sipërmarrje apo institucione partnere. Duke qenë se programi është profesional dhe jo laboratorik, praktikat nuk kërkojnë ambiente të specializuara brenda universitetit. Përkundrazi, ato mund të realizohen në ambientet e sipërmarrjeve dhe bizneseve të rajonit të Korçës, për të ndihmuar studentët në ndërtimin e kompetencave praktike. Megjithatë, në syllabuset ekzistuese nuk është i dokumentuar komponenti praktik, nuk përcaktohen objektiva praktike për lëndë të caktuara, dhe nuk ekzistojnë udhëzime të qarta për vlerësimin e aspekteve të zbatueshme të njohurive. Rekomandohet që Departamenti i Menaxhimit të: • Identifikojë lëndët ku mund të zhvillohen komponente praktike apo mini-projekte në bashkëpunim me sipërmarrje lokale; • Të përditësojë syllabuset përkatëse, duke përfshirë objektiva, aktivitete dhe mënyra të vlerësimit të kompetencave praktike; • Të sigurojë një dokumentim institucional mbi zbatimin e këtyre praktikave në bashkëpunim me aktorët e tregut të punës. <i>Dokument Aneksi II.2 Planit Mësimor</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi I.33 Marrëveshje Institucionale</i>

	<i>Dokumentet Aneksi I.34 dhe Aneksi I.35 Marrëveshje Bashkëpunimi (DM)</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Departamenti i Menaxhimit në UNIKO, synon pajisjen e studentëve me njohuri të aplikuara dhe kompetenca praktike në fushën e administrimit të biznesit. Megjithatë, GVJ vëren se në këtë program nuk është strukturuar një mekanizëm formal për realizimin e praktikave profesionale në bashkëpunim me biznese apo institucione publike/jo publike, siç kërkon ky kriter. Në dokumentacionin e dorëzuar figurojnë marrëveshje bashkëpunimi (Dokumenti Aneks I.33, Aneks I.34, Aneks I.35), të cilat dëshmojnë lidhje institucionale të përgjithshme me aktorë të jashtëm, por asnjë prej tyre nuk është e specifikuar për zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve të këtij programi në formën e një stazhi, projekti në terren, apo bashkëpunimi të ndërtuar me objektiva mësimorë dhe vlerësim formal. Gjithashtu, në Dokumenti Aneks II.15 – Programet Lëndore, nuk gjenden të përshkruara komponentë praktikë apo aktivitete që realizohen në bashkëpunim me partnerë të jashtëm duke përdorur teknologji apo mjete bashkëkohore për përfitimin e kompetencave profesionale. Rekomandim GVJ (i lidhur me Kriterin 2): Rekomandohet që Departamenti i Menaxhimit: • Të vendosë në funksion të këtij programi marrëveshje bashkëpunimi të dedikuara për praktika profesionale dhe stazhe; • Të përfshijë në planin mësimor ose në kuadrin e lëndëve aktivitete të aplikuara që zhvillohen në partneritet me institucione të jashtme (biznese, agjenci zhvillimi, OJF, etj.); • Të dokumentojë dhe të monitorojë pjesëmarrjen e studentëve në këto aktivitete, me qëllim vlerësimin dhe gjurmueshmërinë e kompetencave të fituara. Si qasje praktike lehtësisht e integrueshme për natyrën profesionale të programit, sugjerohet të konsiderohet përdorimi i modelit “challenge-based learning”. Kjo qasje, e aplikuar me sukses në universitete evropiane si Eindhoven

ECOE *91*

	University of Technology në Holandë, bazohet në vendosjen e studentëve përballë sfidave reale të industrisë, të cilat kërkojnë zgjidhje në formë projektsh të strukturuar ndërdisiplinore ose të udhëhequra nga lëndë të caktuara. Në këtë kuadër, kompanitë vendore si “Tona”, “FIX” dhe “Birra Korça”, të cilat kanë kaluar nga profile lokale në marka me shtrirje kombëtare, mund të angazhohen jo vetëm si mjedise pritëse për stazhe, por si bashkëhartues të sfidave praktike që studentët mund të analizojnë dhe zgjidhin gjatë studimeve të tyre. Kjo lloj qasjeje: • rrit ndjeshëm motivimin dhe përgatitjen praktike të studentëve, • e pozicionon universitetin si aktor zgjidhës për nevojat e biznesit, • dhe ndërton marrëdhënie të qëndrueshme e të dobishme për të dyja palët. <i>Dokument Aneksi II.2 Plani Mësimor</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore</i> <i>Dokument Aneksi I.33 Marrëveshje Institucionale</i> <i>Dokumentet Aneksi I.34 dhe Aneksi I.35 Marrëveshje</i> <i>Bashkëpunimi (DM)</i>
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nga shqyrtimi i Dokumenti ANEKSI_IL.2 – Plani Mësimor dhe Dokumenti ANEKSI_IL.10 – Rregullorja e Programit të Studimit, rezulton se programi nuk parashikon një lëndë të veçantë për praktikë, as një modul që të dokumentohet dhe të vlerësohet në përputhje me një strukturë zyrtare. Rekomandohet që Departamenti i Menaxhimit dhe IAL UNIKO: • Të integrojnë një praktikë profesionale apo projekt të aplikuar, me kredite të dedikuara, brenda programit të studimit; • Të hartojnë dhe formalizojnë formate për vlerësimin e praktikës, ku të përfshihen: vlerësimi nga trajneri i jashtëm, reflektimi i studentit, dhe miratimi nga mentori institucional; • Të bëjnë të mundur dokumentimin dhe arkivimin e përvojës së praktikës si pjesë e dosjes së studentit;



	Të sigurojnë që kjo përvojë të reflektohet në suplementin e diplomës, për të dëshmuar angazhimin real të studentit në përvojë praktike.			
Konkluzione	<i>Në kuadër të Programit të Studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi", Institucioni i Arsimit të Lartë "Fan S. Noli" (UNIKO) nuk ka të strukturuar një procedurë të qartë për zbatimin e njohurive nëpërmjet praktikës profesionale. Praktika nuk është e integruar në planin mësimor, nuk është e ekuivalentuar me kredite, dhe nuk dokumentohet si përvojë e monitoruar nga institucioni. Kjo përbën një mangësi thelbësore për një program të ciklit profesional, duke e kufizuar përgatitjen zbatuese të studentëve në përputhje me objektivat e programit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të



akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	angazhuar në Departamentin e Menxhimit e për periudhën 2022-2025 është si më poshtë: 1. Për vitin akademik 2022-2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë PAE (4 Prof.As, 4Dr dhe 1Msc) 2. Gjithashtu për vitin akademik 2023-2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë (4 Prof.As, 4Dr dhe 1Msc Dr në proces). Aktualisht numri i stafit akademik efektiv pjesë e Departamentit të Menaxhimit është 9 (nëntë) 2023-2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë (4 Prof.As, 4 Dr dhe 1Msc, Dr në proces). <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td></td><td>1</td><td></td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>4</td><td></td><td>4</td><td></td></tr><tr><td>Dr</td><td>4</td><td></td><td>4</td><td></td></tr><tr><td>MSc</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>Total</td><td>9</td><td>0</td><td>9</td><td>0</td></tr></table> <i>Dokumenti ANEKSI_I.29 – Personeli Akademik dhe Ndihmës Akademik – Fakulteti Ekonomik</i> <i>Dokumenti ANEKSI_I.30 – Personeli Akademik – Programi MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokumenti ANEKSI_I.31 – Të Dhëna për Personelin Akademik – Departamenti i Menaxhimit</i> <i>Dokumenti ANEKSI_II.18 – CV të Stafit Akademik</i> <i>Dokumenti ANEKSI_IV.1 – CV të Stafit Ndihmës Akademik</i> <i>Dokumenti ANEKSI_IV.2 – Kualifikimi i Stafit Akademik – Fakulteti Ekonomik</i>	Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1		1		Prof.As.Dr	4		4		Dr	4		4		MSc					Total	9	0	9	0
Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2023-2024		2024-2025																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr	1		1																																
Prof.As.Dr	4		4																																
Dr	4		4																																
MSc																																			
Total	9	0	9	0																															
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e	GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik pranë programit të studimit është realizuar në përputhje me kërkesat dhe kuadrit rregullator në fuqi.																																		



studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Aktualisht, personeli akademik efektiv mbulon 100% të ngarkesës mësimore, Nga ana tjetër u konstatua se disa pedagoge PAE realizojnë 5-6 lëndë të cilat në disa raste shkojnë në 400-450 orë. Kjo situatë sidomos e shpërndarjes së lëndëve bie ndesh me Udhëzimin Nr. 29, datë 10. 09. 2018 “Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. Ku thuhet se: Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbaje në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në dy semestra, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore. <i>Dokument Aneksi I.29 Personeli Akademik dhe Ndhimës Akademik – Fakulteti Ekonomik</i> <i>Dokument Aneksi I.30 Personeli Akademik – Programi MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi I.31 Të Dhëna për Personelin Akademik – Departamenti i Menaxhimit</i> <i>Dokument Aneksi II.18 CV të Stafit Akademik</i> <i>Dokument Aneksi IV.1 CV të Stafit Ndhimës Akademik</i> <i>Dokument Aneksi IV.2 Kualifikimi i Stafit Akademik – Fakulteti Ekonomik</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi. Punësimi i stafit PAE është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. <i>Dokument Shtojca 1.4 Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore</i> <i>Dokument Shtojca 1.13 Udhëzimi për Rekrutimin e Stafit Akademik</i> <i>Dokument Shtojca 1.14 Udhëzimi për Përmbajtjen e Dosjes së Stafit</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i> <i>Dokument Aneksi IV.10 Kriteret e Rekrutimit</i> <i>Dokument Aneksi IV.6 Model Kontrata Individuale e Punës</i> <i>Dokument Aneksi IV.7 Format Shpallje Vend Vakant</i>



	<i>Dokument Aneksi IV.8 Format Vendimi – Komisioni Ad Hoc</i> <i>Dokument Aneksi IV.9 Format Urdhër Emërimi</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në RVB por edhe në dokumentacionin bashkangjitur paraqiten qartë procedurat e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë bazohet në rregulloren për punësim në UNIKO, e cila paraqet qartë kriteret. Rregullorja përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. <i>Dokument Shtojca 1.4 Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore</i> <i>Dokument Shtojca 1.13 Udhëzimi për Rekrutimin e Stafit Akademik</i> <i>Dokument Shtojca 1.14 Udhëzimi për Përmbajtjen e Dosjes së Stafit</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i> <i>Dokument Aneksi IV.10 Kriteret e Rekrutimit</i> <i>Dokument Aneksi IV.6 Model Kontrata Individuale e Punës</i> <i>Dokument Aneksi IV.7 Format Shpallje Vend Vakant</i> <i>Dokument Aneksi IV.8 Format Vendimi – Komisioni Ad Hoc</i> <i>Dokument Aneksi IV.9 Format Urdhër Emërimi</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstatoi që Fakultet i Ekonomisë respektivisht Departamenti i Menaxhimit ka një 1 (një) punonjës të angazhuar si personel ndihmës akademik (i kategorizuar si/sekretar) i angazhuar në punët administrative. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori bën pjesë specialisti /Sekretar që është i angazhuar për programet e studimit që ofron Departamenti i Menaxhimit. <i>Dokument Shtojca 1.14 Udhëzimi për Përmbajtjen e Dosjes së Stafit</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i> <i>Dokument Aneksi IV.10 Kriteret e Rekrutimit</i>

	<i>Dokument Aneksi IV.6 Model Kontrata Individuale e Punës</i> <i>Dokument Aneksi IV.7 Format Shpallje Vend Vakant</i> <i>Dokument Aneksi IV.8 Format Vendimi – Komisioni Ad Hoc</i> <i>Dokument Aneksi IV.9 Format Urdhër Emërimi</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion që UNIKO, me përgjegjës Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e stafit të angazhuar në programin e studimit. Pas verifikimit në mënyrë rastësore të dosjeve të personelit akademik, GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar. Përgjegjësi i Departamentit, mbledh, përditëson dhe arkivon çdo vit CV-të e anëtarëve të personelit akademik dhe administrativ të përfshirë në programin e studimit. Gjithashtu zyra e burimeve njerëzore, si pjesë e strukturës organizative të UNIKO, arkivon të dhëna të përgjithshme të dokumentuara në dosjet e personelit. Përditësimi i dokumentacionit bëhet nga specialisti i sektorit të burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivit. <i>Dokument Shtojca 1.14 Udhëzimi për Përmbajtjen e Dosjes së Stafit</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i> <i>Dokument Aneksi IV.10 Kriteret e Rekrutimit</i> <i>Dokument Aneksi IV.6 Model Kontrata Individuale e Punës</i> <i>Dokument Aneksi IV.7 Format Shpallje Vend Vakant</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të	GVJ konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë “Fan S. Noli” (UNIKO), si dhe Fakulteti Ekonomik dhe Departamenti i Menaxhimit, kanë në fuqi marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, organizata dhe biznese në rajonin e Korçës, të cilat në parim mund të përdoren për praktika profesionale apo bashkëpunime akademike. Megjithatë, në Programin e Studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi”, praktika profesionale nuk është e integruar si komponent formal në planin mësimor, nuk është e vlerësuar me kredite dhe nuk dokumentohet në mënyrë të strukturuar. Nga takimi me stafin dhe studentët, GVJ konfirmoi se ka pasur kontakte të pjesshme me kompani pritëse dhe aktivitete të

tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	natyrës bashkëpunuese, të cilat janë zhvilluar në mënyrë informale ose përmes iniciativave të vetë stafit akademik, por këto nuk përbëjnë praktikë të sistemuar dhe të dokumentuar sipas kërkesave të një programi profesional. Kjo tregon se, pavarësisht potencialit dhe vullnetit institucional, mungesa e përfshirjes së praktikës në vetë strukturën e programit mbetet një pikë e dobët, që kërkon rishikim për të përmbushur standardet e një programi Master Profesional. <i>Dokument Aneksi I.33 Marrëveshje Institucionale</i> <i>Dokument Aneksi I.34 Marrëveshje Bashkëpunimi</i> <i>Dokument Aneksi I.35 Marrëveshje Bashkëpunimi (Departamenti i Menaxhimit)</i> <i>Dokument Aneksi II.2 Plani Mësimor i Programit të Studimit</i> <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullorja e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore 2022–2025</i> <i>Dokument Aneksi II.6 Udhëzuesi për Punimin e Diplomës (vetëm për pjesën e detyrimeve përmbyllëse, jo për praktikë)</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Si është përmendur në disa raste më sipër, në rastin e Programit të Studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, GVJ vëren se praktika profesionale nuk është e integruar në strukturën formale të programit, ndaj nuk është i zbatuar ky kriter në mënyrë të dokumentuar dhe të monitoruar. Edhe pse institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione në rajonin e Korçës (shih: Dokumenti ANEKSI_I.33, ANEKSI_I.34, ANEKSI_I.35), nuk ka evidenca që vërtetojnë përfshirjen e personelit mbikëqyrës në institucionet pritëse në procesin e drejtimit dhe vlerësimit të studentëve gjatë praktikës, pasi kjo nuk zhvillohet në mënyrë sistematike në kuadër të këtij programi. <i>Dokument Aneksi I.33 Marrëveshje Institucionale</i> <i>Dokument Aneksi I.34 Marrëveshje Bashkëpunimi</i> <i>Dokument Aneksi I.35 Marrëveshje Bashkëpunimi (Departamenti i Menaxhimit)</i> <i>Dokument Aneksi II.2 Plani Mësimor</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore</i>
Konkluzione	<i>Personeli akademik i angazhuar në programin Master Profesional në Administrim Biznesi përmbush standardet</i>



	sasiore dhe kualifikimet e kërkuara për një program të këtij niveli. Staf i mbulon me kompetencë fushat përkatëse të programit, duke garantuar cilësi në procesin e mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Departamenti i Menaxhimit e zhvillon procesin mësimor në godinën e Fakultetit Ekonomik të UNIKO. Bazuar në dokumentacionin e ofruar, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi që mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor për programin e studimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Përkatësisht, në dispozicion janë: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Mjedisi - FE</th><th>Nr. Sallash</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni + seminari</td><td>15</td></tr> <tr> <td>Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj</td><td>4</td></tr> <tr> <td>Zyra për stafin</td><td>13</td></tr> <tr> <td>Bibliotekë</td><td>1</td></tr> <tr> <td>Zyra Informacioni per Studentë</td><td>1</td></tr> </tbody> </table> <i>Dokument 4.1 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukture dhe laboratorike të FE</i> <i>Dokument Tabelat Përmbledhëse për Aneks Vizita në Institucion</i>	Mjedisi - FE	Nr. Sallash	Salla leksioni + seminari	15	Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	4	Zyra për stafin	13	Bibliotekë	1	Zyra Informacioni per Studentë	1
Mjedisi - FE	Nr. Sallash												
Salla leksioni + seminari	15												
Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	4												
Zyra për stafin	13												
Bibliotekë	1												
Zyra Informacioni per Studentë	1												
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë	GVJ konstatoi gjatë vizitës që sallat që përdorën gjatë procesit mësimor janë të pajisura dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizshëm dhe thjeshtë të montueshëm nga stafi akademik. Sallat e leksionit dhe laboratorit janë të pajisura me video projektorë disa prej tyre dhe me pc-kompjuter, tabela bashkëkohore, kompjuterë dhe vende pune me internet. Godina e FE është e pajisur me linjë interneti dhe												

realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	intraneti (kabëll interneti optik) në të gjitha zyrat e personelit, klasat, laboratorët dhe auditorët, krahas rrjetit të internetit (kabllor/lan) funksionon edhe sistemi ëireless i internetit, duke iu mundësuar studentëve akses interneti edhe në ambjentet e jashtme. Sallat e konferencave ku zhvillohen aktivitete ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare, janë të pajisura me pajisje kompjuterike, monitorë, videoprojektorë. <i>Dokument 4.1 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike të FE</i> <i>Dokument Tabelat Përmbledhëse për Aneks Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Bazuar në vizitën në institucion, por edhe në dokumentacionin e vetëvlerësimit. GJV konstatoi që Fakulteti Ekonomik, i cili ofron programin e studimit, ofron për studentët laboratorë dhe gjithashtu salla dhe mjedise të tjera të pajisura me mjete brenda standarteve për të përmbushur kërkesat e programit dhe për të arritur objektivat e tij. Gjithashtu edhe një sallë për promovimin dhe aktivitetet e qeverisë studentore. <i>Dokument 4.1 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike të FE</i> <i>Dokument Tabelat Përmbledhëse për Aneks Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Fakulteti Ekonomik, i cili ofron programin e studimit, ofron për studentët laboratorin e informatikës, ku studentët kryesisht realizojnë orët e seminareve për këtë program studimi. <i>Dokument 4.1 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike të FE</i> <i>Dokument Tabelat Përmbledhëse për Aneks Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset	GVJ vlerëson se Fakulteti Ekonomik i UNIKO-s disponon ambiente të përshtatshme për mbështetjen e veprimtarive praktike të studentëve të Departamentit të Menaxhimit, përfshirë hapësira mësimore dhe infrastruktura që mund të vihet në funksion të përgatitjes profesionale. Megjithatë, në rastin konkret të Programit Master Profesional në “Administrim Biznesi”, GJV konstaton se këto ambiente nuk

janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulate me kapacitetet e nevojshme.	janë të shfrytëzuara në mënyrë të strukturuar për zhvillimin e praktikës, siç kërkohet nga një program me profil aplikativ. Për më tepër, në kushtet e zhvillimeve të shpejta teknologjike dhe dixhitalizimit të sipërmarrjes, kërkohet një qasje më proaktive nga institucioni për të krijuar ura lidhëse ndërmjet mjediseve të brendshme, aktorëve të biznesit dhe studentëve, duke i përfshirë këta të fundit si agjentë transformues dhe jo vetëm si përfutës pasivë të praktikës. Kjo do të mundësonte jo vetëm aplikimin real të njohurive, por edhe zhvillimin e kompetencave të orientuara drejt nevojave të tregut të punës dhe inovacionit organizativ.			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies dhe për mbështetjen e formimit praktik të studentëve, në përputhje me natyrën dhe fushën e programit të studimit. Këto kapacitete krijojnë bazën për realizimin cilësor të aktiviteteve akademike dhe profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi që pedagogët e lëndëve paraqesin çdo fillim semestri të studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundësohet nga vetë ato dhe biblioteka. Gjithashtu UNIKO vë në dispozicion të studentëve informacione on-line nga burime elektronike si ajo EIFL (Electronic Information for Library). <i>Dokument Aneksi I.37 Librat e Dhuruara</i> <i>Dokument Aneksi IV.14 Fondi i Bibliotekës</i> <i>Dokument Aneksi IV.13 Të Dhëna mbi Infrastrukturen</i>

Elco

	<i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi se në të dyja bibliotekat, si në atë shkencore të UK por edhe në atë të Fakultetit Ekonomik raportojnë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit për të informuar stafin akademik, ndihmës-akademik dhe studentët, mbi botimet e fundit. Tekstet bazë të përdorura në program janë kryesisht në gjuhën shqipe, përfshirë botime të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj, të cilat shpërndahen nga pedagogët si materiale shtesë. GVJ konfirmoi në takimin me stafin se procesi i përditësimit të literaturës iniciohet nga kërkesat e vetë pedagogëve dhe ndjeket nëpërmjet njësisë bazë përkatëse. Gjithashtu, në mbështetje të pasurimit të fondit të literaturës, është realizuar një donacion me libra të specializuar nga Foundation Nestlé Pro Gastronomia, të cilët janë listuar në Dokumenti ANEKSI_I.37 – Librat e Dhuruara dhe mund të shfrytëzohen nga studentët e programit në fjalë, pasi përmbajnë përmbajtje të lidhur me praktikën bashkëkohore të menaxhimit dhe industrisë së shërbimeve. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur RVB-së, veçanërisht syllabuseve në Dokumentin ANEKSI_II.15, konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e lëndëve vijon të përdorë literaturë të pa përditësuar, me botime të viteve të mëhershme. Në shumicën e rasteve, literatura referuese është e autorëve të Fakultetit të Ekonomisë të UT, e cila ndonëse në disa raste mjaft kontekstuale dhe praktike, nuk reflekton gjithmonë zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse. Për këtë arsye, GVJ rekomandon që për lëndët e një programi profesional si Masteri i Administrim Biznesit, të mundësohet prezantimi i studentëve edhe me literaturë të përditësuar ndërkombëtare, të aksesueshme pa pagesë përmes instruktorëve, nga shtëpi botuese të njohura si McGraë-Hill dhe Pearson, të cilat ofrojnë materiale mësimore me rëndësi të veçantë për rastet studimore, menaxhimin strategjik, inovacionin dhe zhvillimin organizativ.

	<i>Dokument Aneksi I.37 Librat e Dhuruara</i> <i>Dokument Aneksi IV.14 Fondi i Bibliotekës</i> <i>Dokument Aneksi IV.13 Të Dhëna mbi Infrastrukturen</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që UNIKO vë në dispozicion të studentëve dhe stafit një fond të përgjithshëm i cili arrin 17205 tituj (dhe 44.042 kopje) në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Bibliotekat ofrojnë një hapësirë studimi prej 562 m2 si dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve. Orari i shpallur gjatë ditëve të javës është 8:00-16:00. <i>Dokument Aneksi I.37 Librat e Dhuruara</i> <i>Dokument Aneksi IV.14 Fondi i Bibliotekës</i> <i>Dokument Aneksi IV.13 Të Dhëna mbi Infrastrukturen</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni por edhe vizita në institucion sikurse e theksuam edhe në kriterin 3, se biblioteka disponon dhe një fond të përgjithshëm i cili arrin për FE 5316 Libra dhe 3610 tituj në shqip dhe gjuhë të huaj , kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Bibliotekat ofrojnë një hapësirë studimi prej 562 m2 si dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve. Fusha e menaxhimit numëron 80 libra, Turizmi 100 dhe financa 30 libra <i>(Dokument Aneksi IV.14 Fondi i Bibliotekës). Studentë të regjistruar në këtë bibliotekë janë 620.</i> <i>Dokument Aneksi I.37 Librat e Dhuruara</i> <i>Dokument Aneksi IV.14 Fondi i Bibliotekës</i> <i>Dokument Aneksi IV.13 Të Dhëna mbi Infrastrukturen</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në	GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e Programit të Studimit Master Profesional në Administrim Biznesi se Universiteti “Fan S. Noli” (UNIKO) ofron akses të lirë dhe pa pagesë në shërbimet e Bibliotekës Shkencore, si dhe në burime të zgjeruara elektronike që shërbejnë si mbështetje për



bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	mësimdhënie dhe për përgatitjen profesionale të studentëve. Përmes platformave si COBISS, JSTOR, si dhe Biblioteka Digjitale e UNIKO-s, studentët mund të aksesojnë literaturë shkencore, artikuj të përditësuar dhe raste studimore të dobishme për fushat e menaxhimit, biznesit dhe administrimit. Gjithashtu, përmes anëtarësimit në Konsorciumin e Bibliotekave Shqiptare dhe pjesëmarrjes në EIFL (Electronic Information for Libraries), institucioni siguron akses në databaza dhe burime mësimore ndërkombëtare, të cilat janë në dispozicion të studentëve të këtij programi pa kosto dhe mundësojnë përgatitje të thelluar në përputhje me standardet e një masteri profesional. <i>Dokument Aneksi I.37 Librat e Dhuruara</i> <i>Dokument Aneksi IV.14 Fondi i Bibliotekës</i> <i>Dokument Aneksi IV.13 Të Dhëna mbi Infrastrukturen</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ, nga vizita e zhvilluar në Institucionin e Arsimit të Lartë “Fan S. Noli”, vlerëson se Biblioteka Shkencore e universitetit dhe ajo e Fakultetit Ekonomik ofrojnë mjedise të përshtatshme për mësimnxënie individuale dhe në grup. Ato janë të pajisura me salla studimi, kompjuterë me akses interneti dhe video-projektorë, duke i krijuar studentëve mundësi për të punuar në mënyrë të pavarur, për përgatitjen e mikrotezës, analizave të rasteve, apo prezantimeve. Gjithashtu, studentët e programit kanë akses pa kufizim në burime ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë, të cilat mundësohen nëpërmjet bibliotekës digjitale të UNIKO-s, platformave si COBISS dhe JSTOR. Këto burime përbushin nevojat akademike të një programi profesional, duke i pajisur studentët me materiale bashkëkohore dhe raste konkrete të aplikimit. <i>Dokument Aneksi I.37 Librat e Dhuruara</i> <i>Dokument Aneksi IV.14 Fondi i Bibliotekës</i> <i>Dokument Aneksi IV.13 Të Dhëna mbi Infrastrukturen</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore</i> <i>Vizita në Institucion</i>



Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ, nga vizita e zhvilluar në Institucionin e Arsimit të Lartë “Fan S. Noli”, konstatoi se bibliotekat e universitetit funksionojnë sipas një rregulloreje të miratuar dhe ofrojnë shërbim të rregullt për studentët, në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Orari i shërbimit të bibliotekave është i shpallur dhe operon nga ora 08:00 deri në 16:00 gjatë ditëve të javës, duke ofruar akses të vazhdueshëm për studentët. Bibliotekat mbulojnë një kapacitet përdoruesish prej 1444 studentësh, me një hapësirë studimi prej 562 m², si dhe me pajisje kompjuterike të vëna në dispozicion për përdorim akademik. Kjo përbën një strukturë funksionale që mbështet nevojat e studentëve të Masterit Profesional në “Administrim Biznesi”, duke u ofruar hapësira për punë individuale, përgatitje të mikrotezës dhe akses në literaturë shkencore. GVJ rekomandon që të vlerësohet mundësia e zgjerimit të orarit të shërbimit gjatë javëve të provimeve ose gjatë përgatitjes së punimeve përmbyllëse, për të garantuar fleksibilitet më të madh. <i>Dokument Aneksi I.37 Librat e Dhuruara</i> <i>Dokument Aneksi IV.14 Fondi i Bibliotekës</i> <i>Dokument Aneksi IV.13 Të Dhëna mbi Infrastrukturen</i> <i>Ev. Vizita në Institucion</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë	Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se stafi i punonjësve të bibliotekës është përgjegjës për raportimin e informacionit që ka të bëjë me përditësimin e fondit fizik dhe fondit on-line të bibliotekës përkatëse. <i>Dokument Aneksi I.37 Librat e Dhuruara</i> <i>Dokument Aneksi IV.14 Fondi i Bibliotekës</i>



qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<i>Dokument Aneksi IV.13 Të Dhëna mbi Infrastrukturen</i> <i>Ev. Vizita në InstitucionDokumenti +RVB MP AB.pdf</i> <i>Dokument Tabelat Përmbledhëse për Aneks</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se standardi plotësohet, pasi institucioni ofron mjedise bibliotekare të përshtatshme, orare të rregullta dhe akses në burime të ndryshme elektronike, të cilat përmbushin nevojat e studentëve të programit Master Profesional në "Administrim Biznesi".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion se sekretaria e UNIKO është përgjegjëse si edhe realizon sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomim. Gjatë takimit në sekretarinë mësimore u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe 1 dosje e zgjedhur studenti në programin MP AB, të cilat rezultuan me informacion të plotë e të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi që përdoret është platforma PITAGORA si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre. <i>Dokumenti Shtojca 1.6 – Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.6.1 – Manual i Sistemit Elektronik PITAGORA</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.10 – Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit të TIK</i>

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në programin e studimit menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore. Ndërsa, Drejtoria e Financës posedon dhe përditëson informacionin në lidhje me stafin akademik dhe administrativ, në funksion të përcaktimit të kategorisë së punonjësve, raportit për ngarkesën mësimore dhe gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me pagat. <i>Dokument Aneksi I.30 Personeli Akademik i Programit të Studimit MP në Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi I.31 Të Dhëna për Personelin Akademik të Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Dokument Aneksi IV.1 CV të Stafit Ndihmës Akademik</i> <i>Dokument Aneksi IV.2 Kualifikimi i Stafit Akademik të Fakultetit Ekonomik</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma digjitale PITAGORA ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e efikasitetit të administrimit të të dhënave për programin Master Profesional në “Administrim Biznesi”. Sistemi ka lehtësuar aksesin në kohë reale nga studentët për informacione si orari i provimeve, rezultatet, kreditet, kurrikula dhe programet lëndore, duke mundur gjithashtu shërbime të përmirësuara sekretarie dhe ruajtje të sigurt të dokumentacionit akademik dhe administrativ. Sistemi PITAGORA është i aksesueshëm nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit, ndërsa rregullorja e programit përcakton qartë funksionet e këtij sistemi, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e personave të përfshirë, përfshirë stafin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. <i>Dokumenti Shtojca 1.6.1 – Manual i Sistemit Elektronik PITAGORA</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.10 – Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit të TIK Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit	GVJ vlerëson se sistemi PITAGORA, i përdorur nga UNIKO për administrimin akademik të programit Master Profesional në “Administrim Biznesi”, përmbush kërkesat për komunikim funksional dhe shkëmbim

Eico 

ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	informacioni ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Përmes platformës, studentët mund të marrin në kohë reale njoftime, rezultate provimesh, programet mësimore dhe kalendarin akademik, ndërsa personeli akademik ka mundësi të shpërndajë materialet e nevojshme, të përditësojë të dhënat dhe të administrojë provimet në mënyrë të strukturuar. <i>Dokumenti Shtojca 1.6.1 Manual i Sistemit Elektronik PITAGORA</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit të TIK</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UNKO garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse. <i>Dokumenti Shtojca 1.6.1 – Manual i Sistemit Elektronik PITAGORA</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.10 – Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit të TIK</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me	GVJ, nga vizita në Institucionin e Arsimit të Lartë “Fan S. Noli”, konstaton se në faqen zyrtare të universitetit (www.unkorce.edu.al) është publikuar informacion i detajuar në gjuhën shqipe mbi strukturën institucionale, programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet dhe njoftimet për studentët. Për




programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	programin Master Profesional në “Administrim Biznesi”, informacioni është i disponueshëm dhe i aksesueshëm për publikun në adresën zyrtare të programit. Në këtë faqe paraqitet struktura e programit, objektivat, lëndët mësimore dhe të dhënat e përgjithshme, përfshirë faktin që programi ndodhet aktualisht në proces akreditimi, çka përbën një praktikë të mirë për transparencën ndaj studentëve dhe publikut të gjerë. https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fe&tipi=mp&programi=admbiz			
Konkluzion e	<i>GVJ vlerëson se IAL UNIKO përmbush këtë standard, pasi ka në funksion një sistem të brendshëm menaxhimi institucional, i cili mbështet në mënyrë të dokumentuar administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ për programin Master Profesional në “Administrim Biznesi”. Sistemi PITAGORA dhe strukturat përkatëse sigurojnë gjurmueshmëri, transparencë dhe efikasitet institucional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në informacionin e dhënë në DVV dhe RVB, si dhe nga vizita e zhvilluar në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit, i cili mbulon programin Master Profesional në “Administrim Biznesi”, funksionon në përbërje të Fakultetit Ekonomik, si njësi bazë akademike, por jo si njësi shpenzuese me buxhet të veçantë. Institucioni i Arsimit të Lartë “Fan S. Noli” ka vetëm një njësi të vetme shpenzuese, dhe buxhetimi financiar realizohet nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës, nën drejtimin e administratorit të UK-së. Procesi i hartimit të buxhetit nis në nivelin e njësisë bazë

Elco 

	(departamenteve), duke u mbështetur në nevojat e tyre specifike për stafin, infrastrukturën dhe mbështetjen akademike për programet që mbulojnë. Pasi shqyrtohen dhe përpunohen nga strukturat qendrore, plani i financimit miratohet nga Bordi i Administrimit, ndërsa ndarja e fondeve ndjek rregullat e përcaktuara në Rregulloren Financiare të UK-së. Për programin Master Profesional në Administrim Biznesi, kjo do të thotë se nevojat e tij financiare reflektohen përmes kërkesave të paraqitura nga Departamenti i Menaxhimit, dhe përfshihen në planin e përgjithshëm institucional të financimit. <i>Dokumenti Shtojca 1.8 Rregullore e Drejtorisë Financiare (EDE)</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.8.1 Rregullorja Financiare</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.20 Rregullore e Bordit të Administrimit</i>
Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentit të Vetëvlerësimit (DVV), konstaton se hartimi i planit të financimit për Departamentin e Menaxhimit, njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi”, bazohet në strukturën buxhetore shtetërore, të ndarë sipas dy zërave kryesorë: Shpenzimet nga granti buxhetor, dhe Shpenzimet nga të ardhurat e vetë universitetit. Plani i financimit i përgatitur nga departamenti detajohet në mënyrë analitike, duke përfshirë shpenzimet për funksionimin operacional, burimet njerëzore, si dhe investimet e nevojshme për logjistikë dhe pajisje mësimore. Kjo strukturë buxhetore përbën bazën mbi të cilën Fakulteti Ekonomik ndërton kërkesat e veta financiare, të cilat më pas integrohen në planin financiar të përgjithshëm të institucionit, i miratuar nga Bordi i Administrimit. Rekomandohet që procesi i buxhetimit të shoqërohet me planifikim afatmesëm të nevojave zhvillimore të programit MP në “Administrim Biznesi”, për të siguruar rritjen progresive të cilësisë dhe të përputhshmërisë me kërkesat e tregut.

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UNIKO auditohet në mënyrë periodike nga tre hallka kryesore. Auditimi i brendshëm financiar nga strukturat e kontrollit të brendshëm të institucionit. Auditimi i jashtëm (i kryer në çdo dy vjet) nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si edhe nga auditimi i jashtëm, i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Universiteti bën të njohur pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera për të pasur transparencë ndaj publikut. <i>Dokumenti ANEKSI IV.16 FONDET&TE ARDHURAT UK.pdf</i> – përmban informacion mbi fondet dhe të ardhurat e Universitetit “Fan S. Noli”, të cilat mbështesin planifikimin dhe menaxhimin financiar për të gjitha njësitë, përfshirë edhe programin Master Profesional në “Administrim Biznesi”. <i>Dokument Aneksi IV.16 Fondet dhe të Ardhurat e UK.</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në informacionin e DVV, në fund të çdo viti rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve të UNIKO. <i>Dokument Aneksi IV.16 Fondet dhe të Ardhurat e UK</i> unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	UNIKO është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UNIKO janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Në rastet kur ka kërkesë të njësisë bazë dhe me miratim të organeve drejtuese të UNIKO, në rastet kur nevojitet financim shtesë, apo përmirësim i situatës financiare, ri-planifikohen ndërhyrje të posaçme në zërat e shpenzimeve (apo në regjistrin e prokurimeve) për nevoja të ndryshimeve eventuale të financimit të programeve të studimeve, duke garantuar mbarëvajtje të veprimtarisë akademike dhe kërkimit shkencor apo të programeve të studimit.



	<i>Dokument Tabelat Përmbledhëse për Aneks</i> <i>Dokument Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"</i> <i>Dokument Shtojca 1.2 Rregullorja e Universitetit "Fan S. Noli" (UNIKO)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë garanton mbështetje financiare të qëndrueshme për realizimin e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe për funksionimin efektiv të programit Master Profesional në "Administrim Biznesi", duke reflektuar një planifikim të integruar të burimeve në funksion të objektivave akademike dhe mbështetjes së studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë VKM Nr 80 të vitit 2015, UNIKO ka sanksionuar në rregulloret e tij në nivel universiteti, fakulteti, departamenti dhe programi studimi një sërë rregullash dhe procedurash që shoqërojnë studentin nga momenti që vendos të aplikojë për programin MPAB deri në diplomimin e tij. Në Kreun VI, Pika B të Rregullores së Fakultetit Ekonomik studentët gjejnë të shprehur elementët kryesorë të informacionit mbi programin e studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi". <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO'</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i>

	<i>Dokumenti Aneksi II.9: Rregullorja e DM</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullorja e programit të studimit MPAB</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregulloret në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë si dhe modalitetet e organizimit dhe funksionimit të Sektorit të Studimeve dhe të TIK, bëjnë të mundur garantimin e barazisë në hyrje dhe në trajtim të studentëve gjatë periudhës së studimeve deri në diplomim. <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi II.9: Rregullorja e DM</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullorja e programit të studimit MPAB</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Hyrja e studentëve në programin e studimit MPAB bëhet bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në të gjitha udhëzimet që në mënyrë periodike dalin nga MAS për rregjistrimet në universitet Qendra e Karrierës dhe Alumnit, në përputhje me Rregulloren e Institucionit, luan një rol shumë të rëndësishëm për këshillimin e studentëve në sistem (atyre që studiojnë BA në UNIKO) dhe të aplikantëve të tjerë. <i>Dokumenti Shtojca 1.1: Statuti i UNIKO'</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Dokumentacioni i nevojshëm për t'u aksesuar nga studentët gjendet në formën hard copy në Departamentin e Menaxhimit, dhe në formën soft në faqen zyrtare të UNIKO- faqja e FE. <i>Nën këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm, mund të shihen dhe forma të tjera të promovimit, sepse një master në MPAB mund të kryqëzohet me shumë programe studimi brenda UNIKO, por dhe për profesionistë të fushave të ndryshme aktive në tregun e punës.</i> GVJ rekomandon që, përveç publikimit të dokumentacionit në formë fizike në Departamentin e Menaxhimit dhe në formë elektronike në faqen zyrtare të UNIKO-s, të zhvillohen edhe forma të tjera të promovimit të programit, përmes materialeve vizuale të thjeshtuara

	(infografikë, video përshkruese, broshura) dhe prezantimeve në ditët e hapura apo në rrjetet sociale të departamentit/fakultetit. Duke qenë se MPAB ka natyrë ndërdisiplinore, ai mund të tërheqë interes nga studentë të programeve të tjera brenda UNIKO-s, por edhe nga profesionistë të fushave të menaxhimit, financës, agrobiznesit dhe administratës publike. Prandaj sugjerohet që strategjia e komunikimit të zgjerohet edhe jashtë universitetit, në bashkëpunim me biznesin lokal dhe institucione të tregut të punës.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Departamenti si rregull propozon çdo vit kuotat dhe kriteret e pranimit, bazuar në kriteret ligjore, kapacitetet njerëzore dhe ato infrastrukturore dhe më pas ato miratohen në Senat. Duhet thënë që në lidhje me këtë program studimi nuk ka kriteret shtesë, përpos atyre ligjore për t'u pranuar apo për të transferuar studimet. Në vlerësimin e ekspertëve, në vitet e fundit, për shkak të dinamikave ekonomike dhe sociale, në përgjithësi në programet master kriteret e pranimit mbeten kryesisht vetëm ato ligjore në IAL. <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi II.9: Rregullorja e DM</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në lidhje me kriterin 6 dhe 7, duhet thënë që institucioni respekton aspektet ligjore të cilat përcillen vit pas viti nga MAS në lidhje me pranimin e kandidatëve që vijnë nga vendet fqinjë shqipfolëse dhe më gjerë, individët me aftësi të veçanta dhe individë që vijnë nga shtresat e marxhinalizuara (kjo reflektohet dhe në faqen zyrtare të UNIKO, ku paraqiten dhe kuotat vit pas viti). <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi II.9: Rregullorja e DM</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Vendimi për kuotat e pranimit të kategorive të studentëve si më lart merret në përputhje me rregulloret e institucionit në Senat, pas propozimeve që vijnë nga njësitë kryesore/bazë. <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i>

	<i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi II.9: Rregullorja e DM</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në përputhje me rregulloren e UNIKO dhe në respekt të aspekteve ligjore dhe administrative, Bordi Administrimit merr vendime në lidhje me ndihmën/mbështetjen e studentëve në ciklin bachelor dhe master. <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson së në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit" UNIKO ka formalizuar përmes rregulloreve dhe procedurave të gjitha elementët nga pranimi deri në diplomim</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në Rregulloren e UNIKO - Kreu VI (Neni 59 – 64), në Rregulloren e Fakultetit Ekonomik - Kreu V (Neni 34 - 41) dhe Kreu VI (Neni 53-58); në Rregulloren e programit të studimit MPAB (Pika 8 dhe 9) paraqiten në mënyrë të hollësishme procedurat e përparimit akademik. - Organizimi i Studimeve që përmban: organizimin e mësimdhënies; frekuentimin, organizimin e procesit të përgatitjes së punimit të diplomës, etj; - Kontrolli i dijës dhe vlerësimi përmban format e vlerësimit të dijës, afatet e provimeve, kushtet e hyrjes në provim, ankimimin, riprovimin përmirësimin dhe mbartjen. - procedurat e transferimit, njohjes dhe njehsimit të periudhave të studimit.

	- fitimi, pezullimi dhe përfundimi i statutit të studentit. <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullorja e programit të studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Sillabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti II.6: Udhëzuesi i diplomës</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregulloret nw nivel institucional, Fakulteti dhe Programi studimi qartwsojnw dhe procedurat e transferimit, njohjes dhe njehsimit të periudhave të studimit. Natyrisht, nw nivel zbatimi koordinatori i programit suporton studentwt nw ekuivalentin nw bashkwpunim me Sektorin e Studimeve dhe të TIK <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullorja e programit të studimit MPAB</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Informimi studentëve për procedurat e përparimit akademik bëhet përmes disa formave: në klasë në ditët e informimit; në sistemin e brendshëm Pitagora, si dhe në vijimësi nga çdo pedagog në mësim në përputhje me silabuset e lëndëve. Elementët e vlerësimit të vazhduar të studentëve qartësohen në silabusin e çdo lëndë dhe përbëhen nga vlerësimi për angazhimin në seminare/detyra e kursit/provimi ndërmjetëm dhe përfundimtar <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullorja e programit të studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Sillabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në Rregullores e UNIKO dhe FE, përcaktohet procedura e realizimit të punimit të Diplomës dhe sezonet që student mund ta mbrojë atë. Ndërsa në Udhëzuesin e Diplomës jepet procedura e hartimit dhe modeli i punimit të diplomës, Gjatë vizitës në institucion, takimeve me stafin e departamentit të Mneaxhimit, takimeve me sekretarinë mësimore dhe studentët që ndjekin MBAB, vlerësuam që përgjithësisht




	rregulloret, procedurat dhe sistemet funksionojnë në plotësimin e veprimtarive mësimore të studentëve. <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullorja e programit të studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Sillabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti II.6: Udhëzuesi i diplomës</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Departamenti i Menaxhimit në bashkëpunim dhe me QKA dhe strukturat e tjera të UNIKO punojnë së bashku për të promovuar programin MPAB. <i>Sugjerimi nga ana e ekspertëve është që të punojnë më shumë me biznesin lokal dhe me rajonin, përfshirë Maqedoninë e Veriut dhe të hartojnë një plan konkret të promovimit të këtij programi studimi</i> <i>Dokumenti Aneksi II.21: Analiza e veprimtarisë së QKA</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program" njësia kryesore dhe bazë ka ngritur strukturën e rregulloreve, dhe procedurat pwr informimin e plotw tw studentwve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe	Studentët kanë disa rrugë për t'u informuar për përmbajtjen e programit MPAB. Fillimisht është faja online e universitetit, fletëpalosjet, komunikimi i drejtpërdrejtë në departament, përfaqesjes komunikuese të Qendrës së karrierës dhe alumnit, faqeve të medias sociale, etj.

Elide *[Signature]*

kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjithashtu gjatë takimit në institucion, stafi akademik qartësoi që në javën e parë të mësimit, Departamenti dhe pedagoët qartësojnë të gjithë elementët që kanë lidhje me programin, lëndët, modalitetet e zhvillimit. Bazuar në Rregulloren e UNIKO dhe FE-UNIKO, studentët gëzojnë të drejtën të përfundojnë studimin në MPAB në një afat ligjor që është dyfishi i periudhës së studimit, kuptuar deri në 2 vite nga momenti i nisjes, përjashtim nga ky rregull bëhet në rastin kur student pezullon studimet e tij për një afat të caktuar kohor për rrethana të caktuara në jetën e tij. <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti 2: RVB</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Programi MPAB përmban 60 kredite, që ndahen mes lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndëve plotësuese, lëndë më zgjedhje; dhe detyrimit përmbyllës të diplomës. Mësimi organizohet në 2 semestra, çdo semestër përmban 30 ECTS dhe zgjat 15 javë. Një burim tjetër i rëndësishëm informacioni është silabusi i lëndëve i cili qartëson llojin e lëndës, numrin e krediteve, semestrin në të cilin zhvillohet, mënyrën e vlerësimit të njohurive, detyrimet e lëndës, frekuentimin. <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullorja e programit të studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Sillabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 2: RVB</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në nivel universiteti, është ngritur Qendra e Karrierës dhe Alumnit, e cila synon të lehtësojë tranzicionin e studentëve drejt tregut të punës, si dhe të forcojë lidhjet me ish-studentët e diplomuar në funksion të ndërtimit të një rrjeti profesional mbështetës për zhvillimin institucional. GVJ vlerëson se kjo strukturë ka nisur të ndikojë pozitivisht në punën e UNIKO, përmes aktiviteteve të informimit, orientimit profesional dhe ndërmjetësimit me aktorë të jashtëm. Megjithatë, konstatohet se ndërveprimi i Qendrës me Departamentin e Menaxhimit dhe Fakultetin Ekonomik është ende i kufizuar, veçanërisht në drejtim të krijimit të mundësive



	reale për praktikë profesionale, punësim apo bashkëpunime në projekte të përbashkëta me sektorin privat dhe publik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për programin Master Profesional në Administrim Biznesi, i cili synon përgatitjen e specialistëve të aplikueshëm në tregun real të punës. <u>Sugjerohet forcimi i bashkëpunimit të Qendrës së Karrierës dhe Alumnit me departamentin, duke ndërtuar një kalendar të përbashkët vjetor aktiviteteve si panairë pune, vizita studimore, leksione nga përfaqësues të bizneseve dhe takime me ish-studentë të suksesshëm. Po ashtu, vlerësohet e nevojshme rritja e ndërveprimit me sipërmarrjet e qarkut të Korçës dhe më gjerë, për të krijuar ura më të forta midis universitetit dhe tregut të punës.</u> <i>Dokumenti Aneksi II.21: Analiza e veprimtarisë së QKA</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Departamenti i Menaxhimit përcakton dhe koordinonin e programit, i cili në thelbin e veprimtarisë së tij është një ndërlidhës i rëndësishëm i studentit me departamentin dhe gjithë procesin akademik. Në përputhje me Statutin e UNIKO dhe Rregulloren e UNIKO, Sektorin e Studimeve dhe të TIK dhe Qendra e Karrierës dhe Alumnit suportojnë studentët për të gjitha nevojat dhe kërkesat e tyre. <u>Gjithashtu, në takimin me studentët u evidentua një lloj paqartësie dhe apatie, në shpjegimin e asaj çfarë ndodh gjatë studimit.</u> <i>Shumë e rëndësishme për t'ju përgjigjur më mirë nevojave të studentëve është ndryshimi orarit në të cilin zhvillohet procesi mësimor. Studentët e nivelit master punojnë kudo në Shqipëri, dhe procesi mësimor duhet organizuar duke vënë në qendër nevojat e tyre.</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullorja e programit të studimit MPAB</i> <i>Dokumenti 2: RVB</i>

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Përmes sistemit Pitagora studentët informohen kryesisht mbi vlerësimin dhe informacione pjesore. <u>Në UNIKO mungon një sistem LMS, i cili do të mundësonte informacionin e plotë mbi përmbajtjen e lëndëve, leksionet, seminarët dhe do të krijonte një ndërveprim të rëndësishëm me studentët. Gjithashtu, sistemi do krijonte mundësinë për vlerësimin dhe “auditimin” e gjithë përmbajtjes së lëndëve dhe elementë të tjerë të punës së pedagogut/</u> <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Aneksi II.10: Rregullorja e programit të studimit MPAB</i> <i>Dokumenti Aneksi II.15: Sillabuset e lëndëve</i> <i>Dokumenti 2: RVB</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit” mbetet më shumë për të bërë për të vënë studentin në qendër.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e UNIKO çdo fakultet ka Sektorin e Studimeve dhe të TIK që funksionon në bazë të të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, mbi këtë bazë njësis kryesore ka formuluar Rregulloren e Sektorin e Studimeve dhe të TIK për FE- UNIKO, që në setin e dokumentave të vendosura në platformën e ASCAL vjen si

	rregullore për krijimin, rregjistrimin, ruajtjen dhe dorëzimin e dokumentave në UNIKO.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në Sektorin e Studimeve mbahen të gjitha statistikat në lidhje me numrin e studentëve: të regjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, rregjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS. Mbështetur në RVB dhe vizitën në institucion rezulton se numri i studentëve për tre vite akademike është: 2022-2023: 22 studentë 2023-2024: 24 studentë 2024-2025: 18 studentë <i>Dokumenti ANEKSI_V.1_TE DHENA STATISTIKORE_STUDENTET.pdf</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në Sektorin e Studimeve dhe TIK. Dosjet e ecurisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për çdo vit akademik, rregjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që ju kërkua stafit u vendos në dispozicion. Gjithashtu, shqyrtuam dhe mbajtjen e të gjithë informacionit në mënyrë elektronike përmes sistemit Pitagora. <i>Dokumenti 2: RVB</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.2: Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.10: Rregullorja e Sektorin e Studimeve dhe TIK</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.6. Marrëveshja me RASh për sistemin Pitagora</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.6.1. Manuali i sistemit Pitagora</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe	Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, Sektorin e Studimeve dhe TIK si pjesë e njësive së Administratës të FE- UNIKO, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i rregjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës.

Eicob



dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Gjatë vizitës në Sektorin e Studimeve dhe të TIK, dosjet fizike dhe “dosjet elektronike”, regjistrat, proces-verbalet, regjistri themeltar dhe çdo dokument tjetër që është nën përgjegjësinë e zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mjaft mirë të sistemuara.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	UNIKO, bazuar në udhëzimet e MAS harton raportet vjetore, me një format standard dhe një nga rubrikat i referohet të dhënave të studentëve për çdo program studimi. Një Raport tjetër i rëndësishëm është dhe analiza vjetore e punës së departamentit, një raport tjetër në tërësinë e dokumentacionit të paraqitur është ai i gjurmimit të studentëve pas diplomimit, të dhënat e të cilit duhet të shërbëjnë dhe për të përditësuar programin. <i>Statistikat mbi tregues të ndryshëm për studentët do të duhet të pasurohen dhe dokumentohen, me qëllim që të ngrihen analiza mbi to</i> <i>Dokumenti Aneksi II.20: Raportet vjetore të DM</i> <i>Dokumenti Aneksi II.20: Gjurmimi i studentëve</i> <i>Dokumenti Aneks V.1: të dhënat statistikore studentët</i>			
Konkluzione	GVJ në lidhje me këtë standard vlerëson se UNIKO administron gjithë informacionin në lidhje me studentët, nga pranimi, ecurinë e tyre në proces, deri në diplomimin e tyre dhe më tej si alumni në përputhje me bazën ligjore, një sërë rregulloresh të brendshme dhe raportime në nivel institucional dhe departamenti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve	Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të

dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	universitetit. Në Statutin e UNIKO dhe në Rregulloren e tij, nene të caktuara i dedikohet të drejtës së studentëve të përfaqësohen në organet e UNIKO, me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe. Sipas Statutit të UNIKO, në Senatin Akademik bëjnë pjesë dhe studentët, përfaqësuesit e të cilëve zgjidhen përmes votimit të studentëve. <i>Dokumenti Shtojcë 1.1: Statuti UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojcë 1.2 : Rregullore UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojcë 1.11: Rregullorja e senatit akademik</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Pjesëmarrja e studentëve është e rëndësishme dhe në komisione të tjera, si: - Komisionin e sigurimit të standardeve të cilësisë; - Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarive dhe marrëdhënieve me studentët; - Grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe - Grupet e tjera ad hoc që mund të ngrihen në nivel njësie kryesore apo bazë; Në takimin në institucion me studentët, GVJ evidentoi nevojën për më shumë dinamike dhe përfshirje reale të tyre. <i>Dokumenti Shtojcë 1.1: Statuti UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojcë 1.2 : Rregullore UNIKO</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Një veprimtari e rëndësishme e sanksionuar me Statut janë Këshillat e Studentëve të cilat mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit. Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimarrje. Pjesëmarrja e studentëve në disa komisione, në Senat, në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimit të programeve, MPAB përfshirë. <i>Dokumenti Shtojcë 1.1: Statuti UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojcë 1.2 : Rregullore UNIKO</i>

Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<i>Pjesë e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të tij, që krijon mundësi e analizave të mëtejshme, por që në formën që bëhet është shumë gjeneralist, nuk është në terma të përmbajtjes së lëndës, të mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, duke mos kontribuar drejtëpërdrejtë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës dhe dinamikës gjatë studimeve.</i> <i>Duhet bërë më shumë për të krijuar traditën e fokus grupeve, mbledhjeve periodike dhe mbështetjes për hapat më tej të karrierës së studentëve.</i> <i>Dokumenti Shtojcë 1.1: Statuti UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojcë 1.2 : Rregullore UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojcë 1.11: Rregullorja e senatit akademik</i> <i>Dokumenti Aneksi I. 17: Rregullore e Këshillit Studentor</i>			
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre" vlerëson që përtej pjesës formale ka hapësira për përmirësim dhe ndërveprim real, IAL – studentë, përmes angazhimit proaktiv të studentëve në proceset akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet	Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rregulloret intitucionale në nivel universiteti dhe fakulteti, në shërbim të informimit të studentit dhe të përparimit të tij në sistem nga momenti që kërkon informacion mbi programin, deri në diplomimin e tij, janë një sërë zyrash brenda njësisë kryesore dhe në rang universiteti.

ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Departamenti angazhohet në të gjithë suportin për procesin mësimor, ndërkohë Zyrat administrative të Fakultetit dhe UNIKO kryejnë një sërë funksionesh lehtësuese dhe suportuese për studentin në system. <i>Dokumenti Shtojcë 1.1: Statuti UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojcë 1.2 : Rregullore UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Kështu, Qendra e Këshillimit të Karrierës, Sektori i Studimeve dhe TIK, Zyra e Financës, vetë departamenti, koordinatori i programit, Drejtoria e Projekteve dhe e Marrëdhënieve me Jashtë i shërbejnë “udhëtimin” të studentit në MPAB, por dhe oportunitetit për Erasmus Exchange në një nga universitetet perëndimore. <i>Dokumenti Shtojcë 1.1: Statuti UNIKO</i> <i>Dokumenti Shtojcë 1.2 : Rregullore UNIKO</i> <i>Dokumenti Aneksi 1.28: Rregullorja e FE</i> <i>Dokumenti Shtojca 1.10: Rregullorja e Sektorin e Studimeve dhe TIK</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Karrierës është krijuar rishtas në UNIKO, dhe po bën përpjekje për punë të planifikuar e dinamike. Ekspertët vlerësojnë që njësia e karrierës dhe alumnit mund të alokohej, apo të kishte përfaqësues të alokuar dhe në FE, ndërveprimi dhe komunikimi vazhdueshëm është shumë i rëndësishëm për të prodhur rezultat. Gjatë takimit të ekspertëve. në FEUNIKO me studentët, evidentuan që studentët në përgjithësi u shprehën pozitivë për eksperiencën e tyre në programin MPAB, ndonëse dukeshin konfuzë për kompetencat që program ofron dhe për perspektivën që ata kanë në tregun e punës..
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna	<i>GVJ sugjeron më shumë aktivitete për studentët, më shumë ndërveprim me tregun e punës, më shumë nxitje për studentët që të aplikojnë për Erasmus, më shumë mundësi intership-esh dhe punësimi.</i>

mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<i>Dokumenti Shtojca 1.10: Rregullorja e Sektorin e Studimeve dhe TIK</i> <i>Dokumenti Aneksi II.20: Gjurmimi i studentëve</i> <i>Dokumenti Aneksi III.1: Model i pyetësorit të studentëve</i>			
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët" vlerëson që ka vend për përmirësim, më shumë ndërveprim e fokus të studenti. Si u permend më lart GVJ sugjeron më shumë aktivitete për studentët, më shumë ndërveprim me tregun e punës, më shumë nxitje për studentët që të aplikojnë për Erasmus, më shumë mundësi intership-esh dhe punësimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e UNIKO, GVJ konstatoi se Institucioni i Arsimit të Lartë ka struktura të qarta për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të ngritura në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. Këto struktura përfshijnë Njësinë e




fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektorin e Kurrikulës, ku është e integruar edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni. Megjithatë, pavarësisht këtij organizimi formal, rekomandohet fuqishëm që kjo strukturë të jetë më proaktive, duke tejkaluar kuadrin administrativ. Duhet të punojë më afër me njësitë bazë për: të ndërtuar mekanizma më gjithëpërfshirës vlerësimi, si p.sh. modele 360° për vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim, të nxisë reflektim periodik mbi përmirësimet e nevojshme, dhe të matë cilësinë përmes indikatorëve të matshëm, që lidhen drejtpërdrejt me performancën akademike dhe zhvillimin profesional të stafit dhe studentëve. Kjo qasje do të forcojë lidhjen midis strukturave të cilësisë dhe përmbajtjes reale të mësimdhënies, duke ndihmuar në rritjen e efektivitetit të programeve studimore dhe të inputeve kërkimore. <i>Dokument Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO</i> <i>Dokument Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokument Aneksi II.21 QKA Analiza e Veprimtarisë</i> <i>Dokument Aneksi II.20 Raportet Vjetore – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.17 Aktiviteti Kërkimor-Shkencor – DM</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se IAL monitoron në vazhdimësi proceset, burimet njerëzore dhe kontekstin e realizimit të misionit të tij si një institucion arsimor dhe kërkimor. Monitorimi bazohet në: • hartimin e raportit të vetëvlerësimit, • anketime të stafit dhe studentëve, • identifikimin e rekomandimeve për përmirësim, • analizat e rregullta vjetore në nivel departamenti, • dhe vlerësimin e performancës së stafit sipas modelit të Manualit të Cilësisë. Megjithatë, GVJ konstatoi se procedurat aktuale të shpërndarjes elektronike të pyetësorëve për studentët nuk janë efikase. Gjatë takimeve, studentët reflektuan një shkallë apatie dhe përfshirjeje formale në proceset e sigurimit të cilësisë. GVJ rekomandon, zhvillimin e fokus grupeve me studentë, që do të ndihmonin në mbledhjen e cilësore të opinionit, rritjen e përfshirjes së tyre, si dhe krijimin e një kulture reflektimi dhe përgjegjësie. Përshtatja e instrumenteve të vlerësimit me


	profilin e studentit dhe kontekstin kohor, për të garantuar më shumë përfshirje domethënëse dhe jo formale në proceset e sigurimit të cilësisë. Këto masa janë të domosdoshme për të rritur efektivitetin e mekanizmave të brendshëm të cilësisë dhe për të forcuar lidhjen ndërmjet studentit dhe institucionit në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të programit. <i>Dokument Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO</i> <i>Dokument Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokument Aneksi II.21 QKA Analiza e Veprimtarisë</i> <i>Dokument Aneksi II.20 Raportet Vjetore – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.17 Aktiviteti Kërkimor-Shkencor – DM</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Kuadri rregullator i UNIKO u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UNIKO. <i>Sikurse është identifikuar edhe më sipër, IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje përtej formalizmit të proceseve, duke kaluar nga vlerësime administrative në mekanizma realisht përmirësues.</i> <i>Kjo nënkupton:</i> • Rritjen e cilësisë së paketës së instrumenteve të vlerësimit, • Zhvillimin e analizave të mirëfillta mbi të dhënat e mbledhura, • dhe përgatitjen e feedback-ut të strukturuar pas çdo vlerësimi, i cili t'i kthehet stafit dhe studentëve për reflektim dhe përmirësim të mëtejshëm. <i>Ky qark feedback–analizë–veprim duhet të jetë i dokumentuar dhe i ndjekur nga njësiti përgjegjëse të cilësisë për të siguruar që mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit sjellin ndikim të matshëm dhe konkret në përmirësimin e programeve të studimit.</i> <i>Dokument Aneksi III.1 Model Pyetësori Studentor</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i>



Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UNIKO. GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve janë diskutuar në mbledhjet e Dekanateve ose në departamente; synimi është nxitja e diskutimit në lidhje me nevojën për përmirësimin e kurrikulës, metodave të mësimdhënies apo infrastrukturës në të cilën ajo zhvillohet. Në fund të çdo viti, rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve. <i>Dokument Aneksi III.1 Model Pyetësi Studentor</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në informacionin e RVB, DVV dhe në takimet me stafin dhe përfaqësuesit e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), GVJ konstatoi se UNIKO ka në funksion mekanizma për të promovuar praktikat e mira dhe për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. Raportet e vlerësimit të performancës së personelit akademik shqyrtohen rregullisht në mbledhjet e departamenteve dhe dekanateve, duke u shndërruar në instrumente reflektimi dhe diskutimi konstruktiv. Gjithashtu, UNIKO mbështet dhe stimulon stafin akademik për përfshirje aktive në kërkimin shkencor, brenda dhe jashtë vendit, përmes mundësive të vitit sabbatik, pjesëmarrjes në tryeza dhe trajnime në kuadër të projekteve ndërkombëtare, si dhe organizimit të veprimtarive që promovojnë kontributin akademik dhe shoqëror të stafit. Në mënyrë të veçantë, GVJ u informua se UNIKO ka filluar të mbështesë financiarisht publikimet shkencore në revista të indeksuara në Scopus, si një formë inkurajimi për përmirësimin e cilësisë kërkimore dhe mësimdhënëse. Ky instrument përforcon ndërlidhjen midis prodhimit shkencor dhe përmbajtjes akademike, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë. Megjithatë, në lidhje me programin e studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi”, GVJ vërejti se pjesa më e madhe e stafit akademik, pas përfitimit të titujve shkencorë dhe akademikë,



	kishte ulur ritmin e angazhimit në veprimtari kërkimore-shkencore. Ky fenomen, i konstatuar edhe në analizat vjetore të departamentit, mund të ndikojë në ruajtjen e cilësisë së përmbajtjes mësimore dhe zhvillimit profesional të mëtijshëm të stafit. Rekomandohet që në nivel IAL, UNIKO të ndërtojë një strategji afatgjatë dhe sistematike të incentivimit, e cila të parashikojë: • bonuse të lidhura me botimet e indeksuara, • përfshirje në projekte kombëtare e ndërkombëtare, • mekanizma monitorimi të angazhimit kërkimor pas titullimit akademik. Kjo strategji do të ndihmonte në ruajtjen e një mjedisi të gjallë akademik, dhe do të garantonte koherencën mes kërkimit dhe mësimdhënies në një program që synon formim profesional të avancuar. të përgjithshëm të programit të studimit dhe mjedisit akademik. Megjithëse u konstatua se në programin Master Profesional në “Administrim Biznesi” ritmi i angazhimit kërkimor të stafit akademik bie pas përfitimit të titujve akademikë, në nivel institucional UNIKO paraqet modele të mira të funksionimit, të cilat mund të shërbejnë si praktikë referimi për të gjitha njësitë. Fakulteti i Bujqësisë, për shembull, është aktiv në projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, organizon veprimtari kërkimore dhe ka krijuar sinergji të qëndrueshme mes kërkimit dhe mësimdhënies. Këto përfshijnë jo vetëm programe studimi të bashkë-dizajnuara, por edhe përfshirjen e studentëve dhe stafit në rrjete bashkëpunimi të aplikueshme dhe me ndikim. Rekomandohet që këto modele të shpërndahen dhe të aplikohen më gjerësisht brenda UNIKO, nëpërmjet një strategjie institucionale që promovon: shpërblimin e meritës kërkimore, mentorimin ndërfakultetesh, integrimin e stafit të rinj në projekte të aplikueshme.
--	--




	Kjo do të ndihmonte në krijimin e një kulture kërkimore të qëndrueshme, që nuk varet vetëm nga angazhimi individual, por mbështetet dhe nxitet në mënyrë strukturore nga vetë institucioni. <i>Dokument Aneksi IV.4 Projekte dhe Mobilitete – FE</i> <i>Dokument Aneksi II.17 Aktiviteti Kërkimor-Shkencor – DM</i> <i>Dokument Aneksi III.1 Model Pyetësi Studentor</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka ngritur strukturat përkatëse dhe ndjek një politikë të qartë për garantimin e cilësisë, duke hartuar dokumente orientuese dhe manualë për vlerësimin dhe zhvillimin e metodave të mësimdhënies. Megjithatë, nevojitet intensifikimi i bashkëpunimit me njësitë bazë për të rritur efektivitetin dhe ndikimin konkret të këtyre politikave në praktikë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GJV konstatoi se, në planin strategjik 2022-2027 të UNIKO, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, dhe planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë. Parimi i cilësisë vlerësohet si udhëheqës i aktivitetit organizativ të IAL dhe duke ndjekur kuadrin ligjor. Në FE siguri i brendshëm i cilësisë realizohet sipas rregullave të përcaktuara në kapitullin XI të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të FE “Vlerësimi i cilësisë “ku specifikohen procedurat dhe strukturat për vlerësimin e cilësisë. Sektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e një plani pune për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe

	në Manualin e Cilësisë të UNIKO dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e NJSBC në fakultete dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. <i>Dokument Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO</i> <i>Dokument Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullore e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.22 Gjurmimi i Studentëve</i> <i>Dokument Aneksi VI.1 GVB</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se UNIKO ka krijuar strukturat e brendshme, proceset dhe udhëzimet e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe ka në përbërje një njësi të posaçme që merret me sigurimin e cilësisë së programeve të studimit dhe me bashkërendimin e procedurave që synojnë përmirësim të vazhdueshëm. Sektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e planeve për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe në Manualin e Cilësisë të UK dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës në fakultete, dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve dhe organeve drejtuese të universitetit, për masat që duhet të ndërmerren. <i>Dokument Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO</i> <i>Dokument Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dokument Aneksi I.28 Rregullore e Fakultetit Ekonomik (FE)</i> <i>Dokument Aneksi II.22 Gjurmimi i Studentëve</i> <i>Dokument Aneksi VI.1 GVB</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB si dhe në vizitën në institucion, GVJ konstaton se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UNIKO realizohet në bashkëpunim me ASCAL, përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit dhe analizave të vazhdueshme institucionale. Në nivel institucional, Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional është pjesë e



përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	administratës së Rektoratit të UNIKO dhe luan një rol kyç në hartimin dhe ndjekjen e procedurave për rritjen e cilësisë. Kjo strukturë propozon masa për përmirësim dhe monitoron zbatimin e tyre për të garantuar standardet akademike të nevojshme në nivel programi dhe institucioni. Megjithatë, GVJ vëren se për të funksionuar si një cikël cilësor dhe i vazhdueshëm i vlerësimit dhe reflektimit, duhet të zhvillohet një paketë e plotë instrumentesh për sigurimin e cilësisë, që përveç pyetësorëve standardë, të përfshijë mekanizma më gjithëpërfshirës si: analiza të thelluara të performancës, fokus-grupe, takime reflektuese me studentë dhe staf, dhe një sistem të qartë feedback-u për të gjitha hallkat. Kjo do të mundësonte ndërtimin e një qarku të plotë monitorimi dhe përmirësimi cilësor të programit të studimit, duke e kthyer procesin nga një detyrim formal në një mjet për përmirësim të vazhdueshëm. <i>Dokument Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO</i> <i>Dokument Aneksi II.20 Raportet Vjetore – DM</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe RVB, si dhe në vizitën në UNIKO, GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e UNIKO dhe Fakultetit Ekonomik, politika institucionale për sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit është e përcaktuar qartë. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie realizohet nëpërmjet pyetësorëve të studentëve për performancën e stafit akademik, si dhe përmes analizave të brendshme që realizohen në nivel departamenti në fund të çdo viti akademik. Rezultatet e treguesve të performancës, të përfshira në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore, diskutohen me stafin në takime reflektuese dhe përdoren për të promovuar praktikën e mira dhe për të nxitur përmirësimin e cilësisë. Megjithatë, nga vizita në institucion dhe diskutimet me stafin, GVJ konstatoi se aktiviteti kërkimor bie dukshëm pas marrjes së titujve akademikë, çka tregon nevojën për një strategji të qartë nxitëse në nivel IAL për të garantuar vazhdimësinë e angazhimit në kërkime dhe pjesëmarrje në projekte akademike,

	si element kyç për qëndrueshmërinë e programeve të studimit. <i>Dokument: Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO.pdf</i> <i>Dokument: Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO.pdf</i> <i>Dokument: Aneks.3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO.pdf</i> <i>Në nivel Departamenti (Departamenti i Menaxhimit, FE):</i> <i>Dokument: Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë.pdf</i> <i>Dokument: Model_Pyetëtori Studentor.pdf</i> <i>Dokument: Ev. Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion, GVJ vlerëson se standardi përmbushet kryesisht . Institucioni ka struktura dhe dokumente rregullatore për sigurimin e cilësisë, por nevojitet forcimi i bashkëpunimit të njësive të sigurimit të cilësisë me njësitë bazë, për një implementim më aktiv dhe efektiv të mekanizmave të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe informacionin e disponueshëm, Departamenti i Menaxhimit në UNIKO ka zbatuar një sërë mekanizmesh për monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore. Këto përfshijnë: Raportet vjetore të veprimtarisë së departamentit, të cilat përmbledhin analizat e performancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Analizat e veprimtarisë së Qendrës së Karrierës dhe Alumni, që ofrojnë feedback mbi përgatitjen e studentëve dhe lidhjen me tregun e punës.

arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Përdorimi i pyetësorëve studentorë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe angazhimit të stafit akademik. Këto instrumente kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe në përshtatjen e tyre me nevojat e tregut dhe standardet akademike. <i>Dokument Aneksi II.10 Rregullore e Programit të Studimit MP Administrim Biznesi</i> <i>Dokument Aneksi II.2 Plani Mësimor</i> <i>Dokument Aneksi II.15 Programet Lëndore 2024–2025</i> <i>Dokument Aneksi II.11 Ndryshime në Planin Mësimor</i> <i>Dokument Aneksi II.20 Raportet Vjetore – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.17 Aktiviteti Kërkimor-Shkencor – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.21 QKA Analiza e Veprimtarisë</i> <i>Dokument Aneksi II.22 Gjurmimi i Studentëve</i> <i>Dokument Aneksi III.1 Model Pyetësori Studentor</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstatoi nga RVB si edhe dokumentat e DVV se raportet e analizës vjetore të mësimin dhe punës kërkimore shkencore që kryhet në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe IAL-je. Të cilat përfshijnë performancën e stafit dhe veprimtarisë në çdo komponent të saj, qoftë atë mësimor apo kërkimor si dhe formimin profesional të studentëve. Këto raporte përmbledhin evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë. <i>Dokument Aneksi II.17 Aktiviteti Kërkimor-Shkencor – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.21 QKA Analiza e Veprimtarisë</i> <i>Dokument Aneksi II.22 Gjurmimi i Studentëve</i> <i>Dokument Aneksi III.1 Model Pyetësori Studentor</i> <i>Ev. Vizita në Institucion</i> <i>Programi i Transparencës i UNIKO –</i> http://unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies,	GVJ konstaton se vlerësimi i treguesve të performancës dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit në UNIKO bazohet në një metodologji që synon matjen e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ky vlerësim përfshin analizën e procesit mësimor, performancën e stafit akademik, organizimin dhe menaxhimin e brendshëm, si dhe veprimtarinë mbështetëse. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies



vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	mbështetet në të dhënat e përfuara nga anketimet e studentëve dhe orët e hapura të leksioneve të mbajtura nga pedagogë me tituj shkencorë. Megjithatë, GVJ vëren se është i nevojshëm përmirësimi i vazhdueshëm i paketës së monitorimit të cilësisë, duke përfshirë zhvillimin e instrumenteve më efektive për mbledhjen e feedback-ut nga studentët dhe stafi akademik. Gjithashtu, rekomandohet që IAL të ndërmarrë masa për incentivimin e cilësisë në kërkim dhe mësimdhënie, për të siguruar një përmirësim të qëndrueshëm të cilësisë së programeve të studimit. <i>Dokument Aneksi II.20 Raportet Vjetore – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.21 QKA Analiza e Veprimtarisë</i> <i>Dokument Aneksi II.17 Aktiviteti Kërkimor-Shkencor – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.22 Gjurmimi i Studentëve</i> <i>Dokument Aneksi III.1 Model Pyetësori Studentor</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i> <i>Dokument Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Bazuar në informacionin e DVV dhe RVB, GVJ konstatoi se programet e studimit në UK i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të cilësisë, nëpërmjet instrumentave të tërthorta të NJBSC-së, organeve vendimmarrëse, stafit akademik dhe studentëve. Këto instrumenta rezultojnë të jenë komplekse: Sjellja dhe veprimtaria e stafit akademik matet edhe me të dhëna e pyetësorëve të studentëve, intervistat në panairin e karrierës, anketimet e ndryshme me të diplomuarit në FE, për të vlerësuar programet e studimit. GVJ vlerëson këtë iniciativë të pasurimit të metodave të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit MP në AB. <i>Dokument Aneksi II.20 Raportet Vjetore – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.21 QKA Analiza e Veprimtarisë</i> <i>Dokument Aneksi II.17 Aktiviteti Kërkimor-Shkencor – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.22 Gjurmimi i Studentëve</i> <i>Dokument Aneksi III.1 Model Pyetësori Studentor</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i> <i>Dokument Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO</i>

Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka ngritur struktura dhe procedura të përcaktuara për monitorimin dhe vlerësimin periodik të programeve të studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Megjithatë, nevojitet një përmirësim i vazhdueshëm i paketës së monitorimit të cilësisë dhe një strategji më e qartë për incentivimin e stafit akademik në kërkim dhe mësimdhënie.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit në DVV dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UNIKO, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në Manualin e Cilësisë specifikohen funksionet e të gjitha strukturave që nga Senati Akademik dhe deri tek pedagogët. <i>Dokument Aneksi II.20 Raportet Vjetore – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.21 QKA Analiza e Veprimtarisë</i> <i>Dokument Aneksi II.17 Aktiviteti Kërkimor-Shkencor – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.22 Gjurmimi i Studentëve</i> <i>Dokument Aneksi III.1 Model Pyetësori Studentor</i> <i>Dokument Shtojca 1.24 Manuali për Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik</i> <i>Dokument Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të	Në rregulloren e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Statuti i UK thekson organizimin strukturor të sigurimit të cilësisë, nëpërmjet rrjetit të

cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	cilësisë apo NJSBC e ngritur në nivel IAL-je si dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UK. <i>Dokumenti.1.1 Statuti i UK.pdf.</i> <i>Dokumenti Shtojca.1.16 Manuali i cilësisë UK .pdf.</i> <i>Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ vlerëson se UNIKO garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve. <i>Kujtojmë këtu nevojën e organizimit ndryshe të pyetësorëve të studentëve në funksion të vjeljes së informacionit, pasi interesimi i realizimit të tyre elektronikisht është i ulët nga ana e studentëve.</i> <i>Dokumenti.1.1 Statuti i UK.pdf.</i> <i>Dokumenti Shtojca.1.16 Manuali i cilësisë UK .pdf.</i> <i>Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ vlerëson se Universiteti “Fan S. Noli” garanton përmes Njësisë Institucionale për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni të arsimit të lartë dhe në bashkëpunim me njësitë përkatëse në nivel fakulteti, një proces sigurimi cilësie gjithëpërfshirës, transparent, të diskutuar me stafet dhe të bazuar në formate e procedura të miratuara dhe të bëra publike. Pranë Fakultetit Ekonomik është ngritur Njësia për Sigurimin e Cilësisë, me anëtarë nga personeli akademik, si edhe një përfaqësues student, i cili është pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi. Kjo njësi funksionon në respektim të plotë të parimeve të integritetit dhe përfshirjes së aktorëve. <i>Dokumenti.1.16 Manuali i cilësisë UK 2020 .pdf.</i> <i>Dokumenti.1.1 Statuti i UK.pdf.</i> <i>Dokumenti Shtojca.1.16 Manuali i cilësisë UK .pdf.</i> <i>Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm	Bazuar në informacionin e paraqitur, GVJ konstaton se mungesa e praktikës mësimore-profesionale në programin Master Profesional në “Administrim Biznesi” në Universitetin “Fan S. Noli” (UNIKO) përbën një pengesë për krijimin e urave efektive ndërmjet institucionit dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Kjo mungesë ndikon negativisht në përmirësimin specifik të cilësisë

që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	së programit të studimit, pasi praktika është një komponent kyç për zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve dhe për forcimin e lidhjeve me tregun e punës. Për të adresuar këtë çështje, rekomandohet që UNIKO të intensifikojë përpjekjet për të vendosur dhe zbatuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe operatorë ekonomikë relevantë. Këto marrëveshje do të mundësojnë organizimin e praktikave të strukturuar për studentët, duke përfshirë partnerë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo qasje do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit dhe në rritjen e relevancës së programeve të studimit me nevojat e tregut të punës. <i>Dokumenti.1.1 Statuti i UK.pdf.</i> <i>Dokumenti Shtojca.1.16 Manuali i cilësisë UK .pdf.</i> <i>Vizita në Institucion."</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. (megjithëse këtu theksojmë nevojën e organizimit ndryshe të pyetësorëve të studentëve)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë	Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, DVV dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO parashikon publikimin e politikave, strategjive dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë. Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti përfshijnë një sërë dokumantash që janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme.

ECOE

transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<i>Dokument Shtojca.1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO.pdf.</i> <i>Ev.Vizita në Institucion.</i> https://unkorce.edu.al/departamenti-i-menaxhimit/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Publikimet në faqen zyrtare Web të UNIKO dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. <i>Ev.Vizita në Institucion</i> https://unkorce.edu.al/departamenti-i-menaxhimit/ <i>.Dokument: Shtojca 1.1 - Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"</i> <i>Dokument: Shtojca 1.2 - Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokument: Shtojca 1.3 - Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dokument: Shtojca 1.16 - Manuali i Cilësisë së UNIKO</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstatoi se FE, në bashkëpunim me departamentet , në fillim të çdo viti akademik miraton një plan veprimi aktiviteteve, të cilat kanë të adresuara dhe synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara nga proceset e vetëvlerësimit dhe marrjes së rezultatit në vitin paraardhës, me qëllim përmirësimin e ecursisë së programeve të studimit për vitin e ri akademik. <i>Dokument: Shtojca 1.1 - Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"</i> <i>Dokument: Shtojca 1.2 - Rregullorja e UNIKO</i> <i>Dokument: Shtojca 1.3 - Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO</i> <i>Dokument: Shtojca 1.16 - Manuali i Cilësisë së UNIKO</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UNIKO realizohen periodikisht analiza gjithashtu si edhe në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet e nevojshme dhe përmirësimet e nevojshme. <i>Dokument Aneksi II.20 Raportet Vjetore – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.21 QKA Analiza e Veprimtarisë</i> <i>Dokument Aneksi II.22 Gjurmimi i Studentëve</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe	Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi se takimet e organizuara në nivel të Njesisë Kryesore (FE) dhe të Njesisë Bazë (DM) ofrojnë informacione të nevojshme tek stafi

studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	akademik mbi arritjet, mangësitë dhe problematikat, lidhur me cilësinë e proceseve të mësimdhënies dhe punës kërkimore, në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme të cilësisë së personelit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm të fushës. <i>Dokument Aneksi II.20 Raportet Vjetore – DM</i> <i>Dokument Aneksi II.21 QKA Analiza e Veprimtarisë</i> <i>Dokument Aneksi II.22 Gjurmimi i Studentëve</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UNIKO realizohen periodikisht analiza në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Ecole 

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Administrim Biznes” ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Pikat e forta dhe afirmime

1. Pozicionimi gjeografik i UNIKO dhe nevoja e tregut rajonal për profesionistë në menaxhim biznesi
2. Numri i qëndrueshëm i studentëve në 3 vitet e fundit
3. Qëndrueshmëria e stafit të departamentit

Pika të dobta

1. Mungesa e reflektimit të zhvillimeve lokale dhe globale në përmbajtjen e programit.(Standardi I.2,Kriteri 3)
2. Lidhje e dobët me tregun rajonal të punës, reflektuar dhe mungesa e Praktikës Profesionale – kategoria D (Standardi III.1,Kriteri 1)
3. Punë e dobët në projekte dhe ndërkombëtarizim(Standardi II.4,Kriteri 6)

Rekomandime

1. Domosdoshmëria që stafi akademik të ketë një përjasje më proaktive ndaj kërkimit, projekteve dhe ndërkombëtarizimit
2. Ndërtimi i skemat formale të bashkëpunimit me industrinë dhe duhen gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikant/interhipet e tyre, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe startupeve të reja, patentave etj.
3. Realizimi i një studimi tregu vetëm për këtë program studimi, përmes një metodologjie që merr në konsideratë të gjithë stakeholder-at e programit
4. Formulimi i silabuseve të lëndëve në përputhje të plotë me VKM 41/2018, nevojitet të përmirësohet përmbajtja e temave, të detajohet literatura e çdo teme dhe të jetë literaturë e 5 viteve të fundit, të rishikohet forma e vlerësimit duke ju përshtatur qëllimit të MP.
5. Rishikimi i përmbajtjes së programit, duke marrë në konsideratë tregun lokal dhe përfshirjen në program të Sipërmarrjes dhe inovacionit, Marketingut Dixhital, Burimeve njerëzore, etj. Më shumë fokus në start up dhe digjitalizim
6. Procesi mësimor të zhvillohet pasdite dhe në fundjavë, duke ju përgjigjur nevojave të studentëve dhe vënë ata në qendër
7. Hartimi i Strategjisë së Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit

8. Hartimi I një plani vjetor të veprimtarive me studentët nga Departamenti në bashkëpunim me QKA

Conclusions of the Evaluation of the Second Cycle Professional Master's Degree in "Business Administration" offered by the "Fan S. Noli" University, Korça

Strengths and affirmations


1. UNIKO's geographical positioning and the regional market need for professionals in business management
2. Stable number of students in the last 3 years
3. Sustainability of the department staff

Weaknesses

1. Lack of reflection of local and global developments in the content of the program.(Standard I.2,Criterion 3)
2. Weak connection with the regional labor market, reflected and lack of Professional Practice – category D.(Standard III.1,Criterion 1)
3. Weak work in projects and internationalization.(Standard II.4,Criterion 6)

Recommendations

1. The necessity for academic staff to have a more proactive approach to research, projects and internationalization
2. Building formal schemes of cooperation with industry and finding ways that enable not only the employment of students and their practices/internships, but also joint projects, supporting new ideas and startups, patents, etc.
3. Conducting a market study only for this study program, through a methodology that takes into account all program stakeholders
4. Formulating course syllabi in full compliance with VKM 41/2018, it is necessary to improve the content of the topics, to detail the literature of each topic and to be literature of the last 5 years, to review the form of assessment by adapting it to the purpose of the MP.



5. Review of the program content, taking into account the local market and the inclusion in the program of Entrepreneurship and Innovation, Digital Marketing, Human Resources, etc. More focus on start-ups and digitalization
6. The teaching process should take place in the afternoon and on weekends, responding to the needs of students and putting them at the center
7. Drafting of the Scientific Research and Internationalization Strategy
8. Drafting of an annual plan of activities with students from the Department in cooperation with the QKA

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Elco

